

Strazbur, 12 mars 2003

Recommendation Rec(2003)3 of the Committee of Ministers to member states on  
balanced participation of women and men in political and public decision making  
**Non-official translation in Albanian**

*Pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në sjelljen e vendimeve  
politike dhe publike.*

Rekomandim Re (2003) nga Komiteti i ministrave deri te vendet -  
anëtare për pjesëmarrje të barabartë të femrave dhe meshkujve në sjelljen e  
vendimeve politike dhe publike i miratuar më 12 mars 2003...  
... dhe memorandumimi shpjegues

Rekomandim Re (2003) nga Komiteti i ministrave deri te vendet - anëtare për  
pjesëmarrje të barabartë të femrave dhe meshkujve në sjelljen e vendimeve politike dhe  
publike i miratuar më 12 mars 2003...

( I miratuar nga Komiteti i ministrave më 12 mars në takimin e ndihmës ministrave)

Duke pasur parasysh se femrat e përbëjnë më tepër se gjysmën e popullatës dhe elektoratit në vendet- anëtare, ato akoma fare pak janë të përfaqësuara në vendosjen e çështjeve politike dhe publike, në pjesën më të madhe të vendeve anëtare;

Duke e pasur parasysh ekzistimin e barazisë de jure, shpërndarjen e fuqisë, shfrytëzimin e resurseve ekonomike, sociale kulturore, këto ende janë në favor të meshkujve sepse femrat ende nuk janë në gjendje t'i shfrytëzojnë të njëjtat për shkak të paragjytimeve në aspektin gjinor;

Funksionimi i sistemeve zgjedhore dhe institucioneve politike duke i përfshirë këtu edhe partitë politike, mund ta pengojnë pjesëmarrjen e femrave në jetën politike dhe publike;

Duke menduar se pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në sjelljen e vendimeve politike dhe publike, është e drejtë njerëzore dhe kusht i domosdoshëm për funksionim më të mirë të shoqërisë demokratike;

Duke menduar se realizimi i pjesëmarrjes së barabartë të femrave dhe meshkujve në sjelljen e vendimeve politike dhe publike do të shpie kah krijim më cilësor i politikës, përmes redefinimit të prioritetëve politike dhe vendosja e pyetjeve të reja në agjendën politike dhe përmirsimi i jetës për të gjithë;

Duke menduar se pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve për vendosjet politike dhe publike është e nevojshme për zhvillimin dhe përbërjen e Evropës, e bazuar në barazi, kohezion social, solidaritet dhe të drejtat njerëzore;

Duke u mbështetur në deklaratën e miratuar në Samitin e dytë të Këshillit të Evropës (në tetor 1977) në të cilin kryetarët e shteteve dhe qeverive folën për „rëndësinë e barazisë më të madhe mes femrave dhe meshkujve në të gjitha sferat e jetës shoqërore duke e përfshirë edhe jetën politike” dhe u angazhuan për „një përparim të vazhdueshëm dhe perspektiv për barazi gjinore”;

Duke e pasur parasysh Konventën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale (1950)dhe protokolet e saj;

Duke e pasur parasysh Kapitullin social të Evropës (1961) Kapitullin e reviduar social të Evropës (1966) dhe Protokolin plotësues të kapitullit social evropian, i cili siguron Sistem për ankesa kolektive (1995);

Duke e pasur parasysh tekstet të miratuara në Konferencën ministrore të Evropës për të drejtat e njeriut, e mbajtur në Romë në vitin 2000;

Duke i pasur parasysh rekomandimet e Komitetit të ministrave të vendeve – anëtare të Këshillit të Evropës: Rekomandimi N<sub>o</sub> R (85) 2 për mbrojtje ligjore ndaj diskriminimit seksual; Rekomandimi N<sub>o</sub> R (96) 5 për harmonizimin e ligjit për punë dhe jetës në familje dhe Rekomandimi N<sub>o</sub> R (98) 12 për mejnstriming (rrjedhat kryesore)

Duke pasur parasysh tekstet e miratuara në Kuvendin Parlamentar; Rekomandimi 1229 (1994) për barazi dhe të drejta të njëjta mes femrave dhe meshkujve; Rekomandimi 1269 (1995) për arritje reale në përparimin e të drejtave të gruas më 1995 dhe Rekomandimi 1413 (1999) për përfaqësim të barabartë në jetën politike;

Duke pasur parasysh Deklaratën univerzale, për të drejtat e njeriut, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, dhe Lidhjen internacionale për të drejtat qytetare e politike;

Duke u bazuar në Konventën për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj gruas, nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) nga viti 1979, veçanërisht nenet 7 dhe 8;

Duke u mbështetur në Platformën Pekingut për aksion si dhe marrëveshjet përfundimtare të mbledhjes speciale të Asamblesë së OKB në vitin 2000 (Peking + 5);

Duke llogaritur se demokracia nuk mundet edhe më tej të vazhdojë me mospërfilljen e aftësive, shkathtësive dhe kreativitetin e femrave, ajo duhet tejet senzitive në balancimin gjinor. Prandaj duhet filluar me integrimin e femrave me profesion, prejardhje dhe mosha të ndryshme për të vendosur në jetën politike e publike në të gjitha nivelet;

Duke i pasur parasysh prioritetet e larta të Këshillit të Evropës për promovimin e të drejtave të njeriut;

Rekomandon që qeveritë e vendeve –anëtare duhet të:

- Të mbështesin pjesëmarrje të barabartë të femrave dhe meshkujve, publikisht të pranojnë ndarjen e barabatë të fuqisë së vendosjes midis të dy gjinive me profesione, prejardhje dhe mosha të ndryshme me çka do të pasurohet dhe forcohet demokracia;
- Të mbrohen dhe të promovohen të drejta të barabarta politike e qytetare të femrave dhe meshkujve duke e përmbajtur njësoj kandidimin për pozicione dhe lirinë e bashkimit politik.
- Të jenë të sigurt edhe femrat edhe meshkujt se mund të disponojnë me votën e tyre dhe të mirren të gjitha masat për eliminimin e votimit familjar.
- Të korrigjohen ligjet dhe praktika me qëllim të sigurimit të strategjive dhe masat e prezentuara në këtë rekomandim të përcillen se a janë implementuar dhe vënë në përdorim.
- Të promovohen dhe inkurajohen veprime për stimulimin dhe përmbajtjen e femrave, të cilat shprehin dëshirë të marrin pjesë në sjelljen e vendimeve politike e publike.
- Të llogarisin, parashtrimin e qëllimeve, kufizimin kohor, me perspektivë për të arritur pjesëmarrje të barabartë të femrave dhe meshkujve në sjelljen e vendimeve politike dhe publike.
- Të sigurohen se rekomandimi është prezentuar para gjithë institucioneve relevante politike, publike, subjektive private, sidomos para parlamenteve kombëtare dhe pushtetit lokal e regjional, shërbimeve qytetare, ndërmarrjeve, sindikateve dhe organizatave joqeveritare (OJQ).
- Vëzhgim dhe evaulim i përparimit dhe të arriturve për pjesëmarrje të barabartë të femrave dhe meshkujve në jetën publike dhe raporton rregullisht Komitetin e ministrave për masat e ndërmarra dhe përparimi i arritur në këtë fushë.

Shtesë ndaj rekomandimit Re(2003)3

Qëllimi i rekomandimit është përfshirja e barabartë e grave dhe burrave në organet vendimmarrëse dhe pjesëmarrja e tyre në çdo organ nuk duhet të jetë nën 40%.

Duke u mbështetur në këtë, qeveritë e vendeve anëtare duhet t'i shqyrtojnë këto kritere:

A. Masa ligjdhënëse dhe administrative  
Vendet anëtare duhet:

1. Të marrin parasysh ndryshime kushtetuese dhe /ose ligjdhënëse, masa pozitive, të cilat do të kontribuojnë për barazi më të madhe në pjesëmarrjen e meshkujve dhe femrave në vendimet politike dhe publike;

2. Të miratohen masa administrative me të cilat gjuha zyrtare do të pasqyrojë ndarjen e barabartë të fuqisë ndërmjet femrave dhe meshkujve;

3. Të marrin parasysh miratimin e ndryshimeve ligjore për barazinë e kandidatëve në zgjedhjet lokale, regjionale dhe nivele më të larta. Atje ku ka lista proporcionale të mirret parasysh aplikimi i ziper sistemit (sistemi zik-zak);

4. Të kihen parasysh aksione ku përmes financimit publik të partive politike të inkurajohet dhe promovohet barazia gjinore;

5. Atje ku është treguar se sistemet zgjedhore kanë ndikim negativ në pjesëmarrjen e grave në organet e zgjedhura, duhet t'i adoptojn, modifikojnë ose t'i ndryshojnë ato sisteme me qëllim që të promovohet barazia gjinore;

6. Të marrin parasysh miratimin e suazave përkatëse ligjdhënëse që janë të drejtuara në kufizimin e konkurentëve, të cilët janë të zgjedhur në disa pozita në të njëjtën kohë;

7. Të miratohet legjislativë përkatëse dhe /ose masa administrative për përmirsimin e kushteve të punës të përfaqësuesve të zgjedhur në nivel lokal, regjional, nacional dhe sub-nacional për të siguruar qasje sa më demokratike;

8. Të miratohen masa përkatëse ligjdhënëse dhe /ose administrative për të përkrahur përfaqësuesit e zgjedhur që t'i harmonizojnë obligimet e tyre publike dhe jetën familjare, veçanërisht duhet përkrahur parlamentet lokale si dhe qeverisjen lokale dhe metodat e tyre të punës që t'u mundëson përfaqësuesve të zgjedhur nga të dy gjinitë t'i harmonizojnë obligimet e tyre ndaj punës dhe familjes;

9. Të marrin parasysh miratimin e masave ligjdhënëse dhe /ose administrative për t'u siguruar që egziston përfaqësim i njëjtë gjinor në të gjitha mbledhjet e konvokuara nga ministria ose qeveria;

10. Të sigurojë egzistimin dhe përfaqësimin e barabartë gjinor në pozita dhe funksione të atyre që janë emëruar nga qeveria ose organe tjera;

11. Të sigurohen se selekcionimi, rekrutimi dhe procesi i emërimit në pozicione udhëheqëse në aspektin gjinor janë senzibilizuar dhe janë transparente;

12. Administrata publike duhet të jetë shembull për barazi gjinore, të bëjnë shpërndarjen e pozitive vendimmarrëse si dhe përparim të barabartë në karrierë;

13. Të merret parasysh përvetësimi i ligjeve dhe / ose masave administrative për t'u siguruar se ka përfaqësim të barabartë në të gjitha delegacionet në nivel kombëtar;

14. Të kenë vëmendje në përfaqësim gjinor kur emërojnë ndërmjetësues për negociata, veçanërisht për zgjidhjen e konflikteve ose në misione të paqës;

15. Të marrin parasysh masa ligjdhënëse dhe/ose administrative me qëllim të përkrahjen punëdhënësit që t'i lejojnë ata që marrin pjesë në sjelljen e vendimeve politike dhe publike, të kenë të drejtë të marrin ditë të lira, pa pasur pasoja për punën e tyre;

16. Të vendosin, atje ku është e domosdoshme të përkrahet dhe forcohet puna e shoqërisë kombëtare për barazi dhe aplikimi i kësaj barazie në jetën politike e publike;

17. Të inkurajohen parlamentet në të gjitha nivelet që të zgjedhin komitete parlamentare ose delegacione për të drejtat e grave dhe mundësi të njëjta dhe ta implementojnë mejnstrimingun gjinor në punën e tyre.

#### B. Masa për përkrahje Vendet - anëtare duhet

18. T'i përkrahin me masa përkatëse, programet të orientuara për stimulimin e barazisë gjinore në jetën politike dhe publike të inicuar nga organizatat e grave ose organizatat të cilat punojnë për barazi gjinore;

19. Të merret parasysh krijimi i një baze për informacione për gratë, të cilat janë të gatshme të punojnë në vende ku sillen vendime politike dhe publike;

20. Të përkrahet dhe zhvillohet veprimi politik i grave duke ju siguruar mundësi grave të zgjedhura të rrjetësohen në nivel lokal, regjional kombëtar dhe ndërkombëtar;

21. Të zhvillohen dhe përkrahen programe ku gratë të cilat duan të kyqen në jetën politike, të kenë mundësi për trajnim dhe aktivitete trajnuese për t'u përgatitur për një rol sa më aktiv në shoqëri.

22. Të inkurajohen dhe mbështeten aktivitete të trajnimit të grave kandidate si dhe për ato të zgjedhura për përdorimin e teknologjive moderne sidomos informatikën.

23. Të inkurajohen nëpër shkolla njësi mësimore përmes të cilave gjeneratat e reja do të ndërgjegjësohen dhe edukohen për barazi gjinore, do t'i largojnë paragjykimet për barazi gjinore dhe do të përgatiten për një shoqëri demokratike.

24. Të promovojnë pjesëmarrje të rinjve veçanërisht grave, nëpër shoqata dhe organizata të ndryshme në të cilat do të fitojnë përvojë dhe do të përgatiten për një rol më aktiv në shoqëri duke përfshirë këtu edhe jetën politike.

25. Të inkurajohen organizatat rinore që të sigurojnë barazi gjinore në strukturat e veta vendimmarrëse.

26. Të mbështetet dhe inkurajohet pjesëmarrja veçanërisht e grave nga nacionalitetet, që të marrin pjesë në postat vendimmarrëse.

27. Të informohen partitë politike për strategjitë që i kanë përdorur vendet e ndryshme për promovimin e barazisë gjinore; dhe të inkurajohen për të implementuar një ose më shumë nga këto strategji me të cilën do të përforcojnë dhe sigurojnë barazi të pjesëmarrjes së grave dhe burrave në postet vendimmarrëse;

28. Të mbështesin programe të inicuar nga partnerët socialë (organizata të punëdhënësve dhe punëtorëve) për promovim dhe pjesëmarrje të balancuar gjinore në poste vendimmarrëse në suazat e aftësive, të tyre gradave dhe në kontekst të marrëveshjes kolektive;

29. Të inkurajohen ndërrmarjet dhe shoqatat të sigurojnë përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në organet e tyre vendimmarrëse, veçanërisht atje ku sigurohen shërbime publike;

30. Të promovohen kampanja, të ngritet ndërgjegjja e opinionit për rëndësinë e barazisë gjinore në të gjitha fushat e shoqërisë dhe proceset vendimmarrëse si kusht për një demokraci të avancuar e të vërtetë.

31. Të promovohen kampanja për ta ndërgjegjësuar opinionin në fushën e veprimtarisë private, dhe përhapjen e një imazhi të ndarjes së obligimeve në mënyrë të barabartë;

32. Të promovohen kampanja, të drejtuara për politikanët dhe partnerët social të cilët rekrutojnë dhe emërojnë kandidatë në detyra të ndryshme, për dobinë dhe avantazhet e gjithë shoqërisë për pjesëmarrjen e grave dhe burrave në organet vendimmarrëse politike dhe publike;

33. Të organizohen seminare interaktive për barazi gjinore, për njerëz që kanë peshë në shoqëri, për liderët e tjerë që të përforcohet ndërgjegjja për pjesëmarrje të balancuar të gjinive në të gjitha nivelet vendimmarrëse;

34. Të mbështeten OJQ dhe institutet hulumtuese të cilët bëjnë hulumtime për pjesëmarrjen e femrave dhe ndikimi i tyre në marrjen e vendimeve dhe rrethin e vendimmarrjes;

35. Të realizohet hulumtim për distribuimin e votave sipas anketave, me qëllim që të përcaktohen shprehitë e grave dhe burrave;

36. Të promovohen hulumtime për pengesat, të cilat e pengojnë kyçjen e grave në jetën politike dhe publike, në organet vendimmarrëse në nivele të ndryshme si dhe të bëhet publikimi i rezultateve;

37. Të promovohen hulumtime për pjesëmarrjen e grave në sektorin social dhe punën vullnetare dhe në organet vendimmarrëse të tyre;

38. Të promovohen hulumtime për senzibilizim gjinor për rolin, pozitat statusin dhe kushtet e punës për gratë e zgjedhura në poste vendimmarrëse;

39. Të promovohet pjesëmarrje e balancuar në pozita vendimmarrëse në medime, menaxhime, programime, trajnime, hulumtime etj.;

40. Të mbështeten trajnime dhe përforsim i ndërgjegjjes së studentëve për gazetari dhe profesionistëve në medime për të senzibilizuar çështjet e balancit gjinor dhe të largohen nga stereotipet diskriminuese të njëjës apo të dy gjinive;

41. Të inkurajohen gratë dhe burrat profesionistë në medime që kandidatët e zgjedhur nga të dy gjinitë të kenë mundësi të barabarta për prezantim në medime, veçanërisht gjatë zgjedhjeve.

Vëzhgim

Vendet – anëtare duhet:

42. Të marrin parasysh vendosjen e komisioneve, si një organ partiak vëzhgues, ose një organ ndërmjetësues, me qëllim të përcillet politika, veprimtaria, e qeverisë në fushën e pjesëmarrjes së grave dhe burrave në jetën politike dhe publike, ose të angazhohet maqineria kombëtare për barazi për realizimin e kësaj detyre.

43. Të marrin parasysh të aplikohen dhe vendosen tregues për hulumtim dhe evoluim të pjesëmarrjes së balancuar të grave dhe burrave në proceset vendimmarrëse dhe në bazë të klasifikimeve të bëhen krahasime ndërkomëtare.

44. Të marrin parasysh miratimin e indikatorëve për avancim në sferën e vendimmarrjes në politikën dhe jetën publike:

- Përqindja e grave dhe burrave përfaqësues të zgjedhur në parlamentet (sub – kombëtarë / kombëtarë/federale / regjionale) dhe kuvendet lokale sipas partive politike.
- Përqindja e grave dhe burrave përfaqësues të zgjedhur në parlamentet ( sub – kombëtarë /kombëtarë) të krahasuar me numrin e kandidatëve sipas partive politike ( shkolla e suksesit );

- Përqindja e grave dhe burrave në qeveritë kombëtare, federale dhe regjionale;
- Numri I grave dhe burrave ministra më të vjetër/ më të rinjë në sfera të ndryshme (portfolia – ministra ) në qeveritë kombëtare, federale dhe regjionale të vendeve – anëtare;
- Përqinja e grave dhe burrave të ranguar, nëpunësit dhe distribuimi i tyre në fusha të ndryshme të veprimit;
- Përqinja e grave dhe burrave gjykatës në gjyqet supreme;
- Përqinja e grave dhe burrave në organe të emëruar nga qeveria;
- Përqinja e grave dhe burrave në organet e partive politike të cilat vendosin në nivel kombëtar;
- Përqinja e grave dhe burrave anëtarë në organizata të punëdhënësve dhe përqindja e grave dhe burrave në organet e tyre vendimmarrëse në nivel kombëtar;

45. Të aplikojnë çdo dy vjet raporte në parlamentet e tyre nacionale dhe masat të cilat janë shqyruar për përparimin e aritur, sipas treguesve të paraqitur më lartë;

46. Të publikohen çdo dy vjet raporte dhe masat për përparimin e arritur për pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje dhe t'i disiminojnë të dhënat;

47. T'i publikojnë dhe të bëjnë statistika për pozitat politike të përfaqësuesve të zgjedhur të cilat do të publikohen dhe do t'i kenë informatat për gjininë, moshën, profesionin (publik / privat) trajnimet;

48. Të përkrahen analiza permanente për prezantimin dhe portretizimin e grave dhe burrave në TV në lajme dhe programe tjera veçanërisht gjatë kampanjave zgjedhore;

Memorandum shpjegues

Përmbajtja

Prezantimi

- A. Prapavija historike dhe juridike
- B. Demokracia – kërkesat e reja
- C. Prejardhja e rekomandimit: puna e Këshillit të Evropës  
Komente për rekomandim

- A. Preambula
- B. Dispozitat e preambulës

Shtesë e rekomandimit

Paraqitje



- A. Masat ligjdhënëse dhe administrative
- B. Masa për përkrahje
- C. Vëzhgim

Shtesa I - Qëllime

Shtesa II – Balanci gjinor në nominimet publike

Shtresa III – Ndryshimet kushtetuese dhe ligjore për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë

Shtesa IV – Barazi gjinore në komitetet publike

Shtesa V – Komisione parlamentare ose delegacione për të drejtat femërore dhe mundësi të njëjta

Shtesa VI – Bankë për gra të talentuara

Shtesa VII – Pritje politike dhe promovimi për pjesëmarrje të barabartë

Disa veb – sajte interesante

Vërejte ( shënime ) përfundimtare

#### A. Prapavija historike dhe juridike

1. Koncepti I përfaqësimit është thelbi I demokracisë moderne, njerëzit interesat e tyre I shprehin përmes përfaqësuesëve të vet, të zgjedhur në mënyrë demokratike. Me këtë traditë e drejta të jesh përfaqësues dhe e drejta të zgjidhet përfaqësuesu bënë të drejta univerzale dhe fundamentale të cilat janë të garantuara edhe me kushtetutë. Sidoqoftë e drejta univerzale për votim ka qenë e rezervuar vetëm për burrat.

2. E drejta për të votuar dhe për t'u kandiduar në zgjedhje ishte kërkesë primare e lëvizjes për të drejtat e grave në shek. XIX dhe gjysmën e parë të shek. XX. Në fund të shek. XIX gratë në Evropë, vetëm në disa vende e fituan të drejtën për të votuar. Pas Luftës së Parë Botërore kjo e drejtë u vendos edhe në disa vende, kurse në shumë shtete gratë duheshite të presin mbarimin e Luftës së Dytë Botërore e në disa shtete edhe vitet e 70 e 80 të shek. XX;

3. Edhe pse egzistojnë të drejta të barabart për të dy gjinitë, si dhe mundësi për vendosje në jetën politike e publike, prap se prap politika dhe organet vendimmarrëse janë sfera ku dominojnë burrat. Burrat vendosin për prioritetet në politikë, kultura politike vazhdon edhe më tej të jetë pro – mashkullore e orientuar. Ka shumë pengesa të cilat kontribuojnë që gratë gjithnjë me vështirësi të marrin pjesë në sjelljen e vendimeve politike dhe publike:

- Fakti se pozita e shumë grave në shoqëri s'është tërëhjekëse për partitë politike etj. (modele dhe vlera që fshehen nga komponente të ndryshme në shoqëri si familja, shkolla, mediumet).

- Faktori kulturor dhe ideologjik (prezentimi I roleve të grave dhe burrave të cilat shpiten kah ideologjia gjinore e përcaktojnë mbështjelljen e çdo individi në shoqëri si dhe shpresat e Individit)
- Faktorët të cilët kanë të bëjnë me organizimin e jetës socialëe(ndarja sociale e punës, e cila grave ju le pak hapsirë për pjesëmarrje tyre në tregun e punës dhe përkrahje fare e vogël nga familja ose mosaftësia e tyre për t'iu përcjellur kërkesave për pjesëmarrje).

4. Kyçja e grave në organet përfaqësuese, gjithashtu, mvaret nga shumë faktorë që lidhen me organizimin e jetës politike. Ritmi dhe ritualet që lidhen me jetën politike si dhe procesi I selekcionimit dhe kriteret për selekcionim në suazat e partive politike mund të jenë shumë të disfavorshme për gratë dhe kontribuojnë për çkyqjen e tyre nga jeta politike. Egziston lidhje e fuqishme mes zgjedhësve dhe numrit të grave në parlamentët kombëtare.

5. Deklarata univerzale për të drejtat e njeriut është akti themelues I OKB dhe I shuma konventave tjera të cilat janë ratifikuar në gjysmën e dytë të shek.XX. Edhe nëse nuk bëhet fjalë për barazi gjinore, dhe pjesëmarrje në politikë në aspektin gjinor, konventat dhe Deklarata, në preambulën e vet I afirmojnë të drejtat e barabarta të femrave dhe meshkujve si të drejta të patjetërsueshme dhe fundamentale dhe kërkon të sigurohet realizimi I tyre dhe të jenë publike për njerëzit dhe qeveritë e vendeve – anëtare.

6. Në Nenin 21 të Deklaratës thuhet se secili ka të drejtë të merr pjesë në qeverinë e vendit të vet qoftë drejtpërsëdrejti ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur. Sipas Nenit 7, të gjithë personat kanë të drejtë të njëjta para ligjit dhe mbrojtje nga ligji dhe nga çdo diskriminim. Këto të drejta njerëzore gjithashtu janë të cituara në Shtesën Ndërkombëtare për të drejta politike e qytetare, e cila hyri në fuqi më 1976, poashtu interesohet për të drejtat e barabarta gjinore me theks që gratë të votojnë dhe të jenë të votuara (Neni 25, paragrafi b).

7. As Deklarata, e as Shtesa Ndërkombëtare nuk I obligojnë shtetet për promovimin e barazisë gjinore dhe sigurim për pjesëmarrje të barabartë të femrave dhe meshkujve në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Ato sigurojnë të drejta ,mbrojtje të ligjit dhe mbrojtje nga diskriminimi, ashtu siç është paraqitur në deklaratë, pa marrë parasysh gjininë. Shteti ka përgjegjësi për të siguruar mundësi të njëjta por jo edhe të garantojë rezultate. Përkufizimi I barazisë gjinore si e drejtë themelore kah mesi shk.XX ishte progresive e bazuar mbi vizionet e ardhshme të botës, por për shumicën kjo nuk ishte e mjaftueshme.

8. Asambleja e OKB – së periudhën prej vitit 1975 deri më 1985 e shpalli dekadë për të drejtat e gruas. Në vitin 1979 Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave e cila ishte e hapur për nënshkrim.

Për herë të patë në konventë internacionale është shënuar roli dhe përgjegjësia e qeverive për t'iu shfrytëzuar të gjitha masat për të siguruar barazinë e grave dhe pjesëmarrjen e tyre në jetën politike dhe publike. Shumë vende të botës, duke përfshirë këtu edhe disa vende evropiane, kanë vënë edhe nene rezervë në KESVNPZH Konventën. Sido që të jetë as një vend evropian nuk ka dhënë nen rezerv për Nenin 7 për

përfaqësim të barabartë në sjelljen e vendimeve politike, ose Neni 8 për mundësi të njëjta që të dy gjinitë, t'i përfaqësojnë qeveritë e veta në nivel ndërkombëtar dhe të marrin pjesë në punën e organizatave ndërkombëtare.

9. Andaj mund të përfundojmë se shtetet evropiane kanë obligim për të siguruar pjesëmarrje të njëjtë të femrave dhe meshkujve në sjelljen e vendimeve politike e publike. Duke e ditur se ndjenja tradicionale për mundësi të njëjta u transformua në kërkesë për barazi në rezultate, tani shtetet kanë obligim të sigurojnë barazi të rezultateve. Kjo do të thotë se shtetet evropiane janë të obliguara të sigurojnë përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në vendosje.

#### Demokracia – kërkesa të reja

10. Kanë kaluar më se 25 vjet nga Dekada e gruas e shpallur nga OKB – ja. Për shumë gra të botës edhe Evropës u bënë ndryshime të mëdha. Janë bërë ndryshime të pozitës së gruas dhe tani ato mund t'i gë'ijnë të drejtat e veta themelore. Sot gjithnjë e më shumë ka gra të shkolluara që kanë mundësi të marrin pjesë në tregun e punës. Në disa vende merren masa t'iu ndihmohet grave dhe burrave t'i harmonizojnë obligimet familiare dhe ato të punës. Ndryshimi i statusit të grave mundësoi që më rëndë të arsyetohet pjesëmarrja e pamjaftuar e grave në sjelljen e vendimeve politike dhe publike.

11. Tradita demokratike e bazuar në ndarjen e pushtetit në ligjdhënës dhe ekzekutiv dhe gjyqësi të pavarur, është sulmuar sepse është e kufizuar. Shteti demokratik i përkufizuar si supreme matija ( qeveri supreme ) e njerëzve ku kohë pas kohe organizohen zgjedhje të lira me vota të fshehta, e udhëhequr nga sundimi i shtetit juridik ku respektohen të drejtat e njeriut, nuk është gjithmonë garancë për demokraci të mirëfilltë. Kërkesat gjinje e më të mëdha dhe nevoja për transparencë të vendimeve të qeverisë të drejta për të pasur qasje në informatat oficiale, theksimi për udhëheqje dhe përmbajtje të ombucmanëve bën që qeveritë të jenë më të matura në vendimet dhe veprimet e tyre. Me këto kërkesa, pritet që pushtetin ta ndajnë në mënyrë të barabartë mes femrave dhe meshkujve. Obligim i qeverisë në këto vizione dhe dimensione të reja janë shpallur në disa konferenca në nivel të lartë, si Samiti i dytë i kryetarëve të shteteve të Këshillit të Evropës i mbajtur në Strazburg më 1997, Konferenca e katërt ministrore për barazi mes grave dhe burrave e mbajtur në Stambull më 1997 dhe Konferenca ministrore evropiane për të drejtat e njeriut e mbajtur në Romë në vitin 2000.

12. Shënimet statistikore për pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe në sjelljen e vendimeve politike e publike, shpesh shfrytëzohen si tregues i nivelit të barazisë gjinore në një shtet. Statistikat në të cilat sipas gjinisë ( veçmas ) shënohet pjesëmarrja në sjelljen e vendimeve politike dhe publike, në shtetin demokratik është indikator që tregon nivelin e ndikimit të grave që e kanë në shoqëri, ku dhe në ç'masë gratë dhe burrat e ndajnë pushtetin. Dihet se gratë duhet arritur masë kritike së paku të jenë të përfaqësuara në të gjitha organet ligjdhënëse me një të tretën për të arritur të bëjnë ndikim real në vendimet e sjellura nga ato organe.

#### C. Prejardhja e rekomandimit:

## Puna e Këshillit të Evropës

13. Me qëllim që të promovohet demokraci e mirëfilltë si dhe të drejtat e njeriut, vendet – anëtare të Këshillit të Evropës si prioritet patën që në fushën e barazisë gjinore të sigurojnë nivel të lartë të pjesëmarrjes së të dy gjinive në sjelljen e vendimeve politike dhe publike.

14. Deri tani, gjatë shumë viteve, organizata ju kushton kujdes të veçantë subjekteve të barazisë në demokraci. Për konceptin e paritetit – barazisë për herë të parë është diskutuar në seminarin „ Parimi demokratik I përfaqësimit të barabartë – 40 vjet nga puna e Këshillit të Evropës ” ( Strazburg, 6 – 7 nëntor 1989 ). Si vazhdim I atij seminari, një grup eksperimentesh filluan të hartojnë një raport për barazi demokratike, I cili u publikua në fillim të vitit 1995. Përveç sqarimit të konceptit, në këtë raport u shtruan strategjitë të cilat do t’iu mundësojnë grave të shndërrohen në „ lojtarë ” të fortë në shoqëri, si kontribues dhe shfrytëzues, të kenë detyra, obligime dhe të drejta të barabarta me burrat. Këto strategji u bënë si udhërefyes për vendosjen e barazisë në organe të ndryshme të qeverive dhe partive politike.

15. Për pjesëmarrjen e grave në vendimet politike shpesh diskutohet nga ana e ministrave të Evropës përgjegjës për barazi gjinore. Tema e Konferencës së parë ministrative (Strazburg, 4 mars 1986 ) ishte „Pjesëmarrja dhe strategji në marrjen e vendimeve”. Një nga tekstet të miratuara në Konferencën e dytë ministrore ( Vienë, 4 – 5 korrik 1989 ) shqyrtoi „ Politikat dhe strategjitë për arritje reale të barazisë mes gjinive. Në Konferencën e katërt ( Stamboll 1374 nëntor 1997 ) ministrat e miratuan deklaratën për barazi gjinore si kriter fundamental për demokraci, së bashku me strategjitë multidisiplinare të orientuar kah përfaqësimi I barabartë I grave dhe burrave në të gjitha etapat e jetës, duke e përfshirë edhe jetën politike.

16. Miratimi I Deklaratës së Stambollit ishte një hap shumë I madh në rrugën për vetëdijesimin e shoqërisë evropiane se barazia gjinore është kusht I domozdoshëm për demokraci, barazi sociale dhe administratë transparente. Përgaditja e këtij rekomandimi paraqet vazhdimësi logjike e Konferencës së Stambollit. Poashtu Kuvendi parlamentar I Këshillit të Evropës në vitet e fundit vazhdimisht e obligon Komitetin em ministrave që ta realizojë këtë detyrë Konferenca ministrore për të drejtat e njeriut e mbajtur në Romë më 2003, e shprehu shqetësim për vazhdimësinë e pabarazisë e cila reflektohet mbi gratë dhe e përshëndeti punën e Këshillit të Evropës me qëllim që të tejkalohen të njëjtat.

## Komente për rekomandimin

### A. Preambulla

17. Në preambullën, marëveshjet dhe rekomandimet kryesore ndërkombëtare, kanë të bëjnë me barazinë gjinore në vendimet politike këto janë të paraqitura me deklaratat për obligimet ndër kombëtare që kanë qeveritë e vendeve – anëtare të Këshillit të Evropës. Barazia de – jure dhe fakti se gratë e përbëjnë më tepër se gjysmën e popullatës në Evropë, ato akoma shumë pak janë të kyqura në sjelljen e vendimeve politike dhe publike. Qeveritë e shteteve evropiane në shumë raste kanë pranuar dhe kanë deklaruar se ndarja e

pushtetit mes gjinive është parakusht për demokraci të mirëfilltë dhe për funksionim më të mirë të shoqërisë demokratike. Preambulla në këtë fakt thekson dhe rekomandon se pjesëmarrja e barabartë është e dobishme për zhvillimin e shoqërisë demokratike.

18. Gjithashtu preambulla e shqyrton procesin e konstituimit të Evropës së bashkuar dhe demokratike, në të cilin janë angazhuar vendet – anëtare më të vjetra dhe ato më të reja. Ky proces nëse me të vërtetë do t'i mbron dhe promovon të drejtat e njeriut, duhet të bën orvatje për të siguruar inter alia ( pa pjesëmarrje të personave të tretë ) pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në sjelljen e vendimeve politike dhe publike. Komiteti I ministrave të Këshillit të Evropës, cili është vatra e të drejtave të njeriut dhe demokracisë, I trimëron vendet – anëtare të punojnë për pjesëmarrje të barabartë, dhe në shumë vende kjo është kuptuar si pjesë e reformave.

## B. Dispozitat e rekomandimit

### Paragrafi 1.

19. Qeveritë e kanë rolin kryesor për promovimin e barazisë gjinore në procesin e vendimmarrjes. Me ratifikimin e marrëveshjeve për të drejtat e njeriut dhe me miratimin e rekomandimeve të ndryshme të përmendura në preambullë ato janë obliguar të punojnë për barazi dhe demokraci të mirëfilltë në shoqërinë e tyre. Me shpalljen e obligimit, qeveritë I reafirmojnë obligimet e tyre në këtë fushë. Demokratat e këtillë mund të ndikojë që t'ua kujtojë departamenteve tjera obligimet që I kanë si dhe partive politike dhe institucioneve shtetërore. Duke e respektuar këtë qeveritë mund të luajnë rol të rëndësishëm duke dhënë shembull të cilin duhet ndjekur. Ministrat e shteteve të cilët morën pjesë në Konferencën e katërt evropiane të ministrave për barazi gjinore e cila u mbajt në Stamboll 1997, deklaruan se qëllimi që duhet të arrihet është demokracia, në të cilën gratë dhe burrat janë të njëjtë pra të barabartë dhe se duhet të ndiqet, INTER ALIA, ku përmes strategjive specifike dhe multidiciplinore do ta senzibilizojnë jetën politike e shoqërore. Me qëllim që të etablohet deklarata politike e cila e shpjegon ndarjen e barabartë të pushtetit dhe vendimmarrjes midis dy gjinive dhe e pasqyron, forcon demokracinë, u obliguan ta arrijnë qëllimin për barazi gjinore.

20. Me qëllim që ky rekomandim të bëhet efektiv në nivel kombëtar, është me rëndësi që çdo qeveri publikisht të obligohet se do të promovojë barazi në ndarjen e pushtetit.

### Paragrafi 2 dhe 3

21. E drejta për të votuar dhe e drejta për të marrë pjesë në qeverisjen e një shteti dhe angazhimi në politikë janë aktivitete themelore të të drejtave të njeriut dhe kritere fundamentale të demokracisë. Gjithashtu kjo ka të bën me të drejtën e organizimit si dhe liritë tjera individuale. Shtesa ndërkombehtarë për të drejta politike e qytetare e marrëveshjes Evropiane për të drejtat njerëzore si dhe Deklarata e OKB për të drejtat e njeriut i garantojnë këto të drejta.

Palët e shteteve në Konventën dhe Dekleratën jo vetëm që e marrin obligimin t'i respektojnë dhe sigurojnë të drejtat e secilit qytetar pa kufizime, por obligohen për të siguruar të drejta të barabarta gjinore.

22. Shembujt nga Evropa për të ashtuquajturun „votim familjar” do të thotë se një anëtar i gjinisë mashkullore i familjes i shoqëron një ose dy gra deri te kabina për votim. Grupet familjare votojnë së bashku ose një anëtar, zakonisht mashkull voton për anëtarët tjerë gra të familjes. Besimet dhe qëndrimet e ashpra i ndalojnë gratë të disa grupeve minoritare t'i shfrytëzojnë të drejtat e tyre qytetare e politike si dhe të drejtën për votim. Mund të supozohet se qëndrimet dhe besimet dhe niveli kulturor poashtu i ndalojnë gratë të angazhohen në aktivitete politike në vendet e tyre. Prandaj me rëndësi jetike është që qeveritë të fillojnë me zgjidhjen e këtyre problemeve dhe t'i kyqin gratë në jetën politike e cila nënkupton edhe votim dhe kandidim. Informatat të dedikuara për grupe të veçanta të njerëzve në shoqëri dhe ngritja e nivelit të ndërgjegjes janë mjete të nevojshme për zgjidhje të këtij problemi, së bashku me masat e propozuara në paragrafët që vijojnë. Platforma për aksion e Pekinit është inicim për mbrojtjen e të drejtave femërore.

#### Paragrafi 4

23. Revizioni i legjislativës kombëtare është parakusht për implementimin e rekomandimit. Por, kjo nuk do të thotë se qeveritë duhet të kufizohen në miratimin e ligjeve. Pjesëmarrja e barabartë e grave dhe burrave në jetën politike e publike ka të bën me definimin dhe miratimin e strategjive si intervenim global dhe transparent në të cilin përfshihet jo vetëm qeveria, por edhe një numër i madh „lojtarësh”, të cilët janë të cenuar nga joprezenca e grave në maqinerinë për barazi në organet vendimmarrëse, OJQ, hulumtues, funksionarë politik në nivel regjional kombëtar, sub – kombëtar etj.

#### Paragrafi 5

24. Projektet e ndryshme dhe masat e përkohshme të implementuara në vendet – anëtare të Këshillit të Evropës me qëllim që të promovohet barazia gjinore në pozitat vendimmarrëse u treguan si shumë të dobishme. Disa nga këto projekte janë të përshkruara në raportin e Këshillit të Evropës në fushën barazisë gjinore. Në këtë raport i hartuar nga prof. Alison Vudvard, paragrafi 5 i këtij rekomandimi është i drejtuar deri te qeveritë që t'i promovojnë dhe mbështesin masat e veçanta në këtë fushë. Kreu i tretë i cili tregon shembuj për masat i inkurajon qeveritë që ti miratojnë edhe masat tjera po me këtë vlerë. Kreu B i këtij rekomandimi përmban edhe disa masa të këtij lloji.

#### Paragrafi 6

25. Rëndësia e qëllimeve të kufizuara në kohë është theksuar në punësimet publike dhe vendosjen në pozita vendimmarrëse në politikkë. Përvoja ka treguar se përkufizimi i qëllimeve dhe kohës janë instrumente të rëndësishme të cilët garantojnë rezultate dhe e sigurojnë evoluimin e duhur. Përveç kësaj kjo është signal i fuqishëm i qeverisë për të krijuar barazi gjinore për sjelljen e vendimeve.

26. Një numër i madh i organeve të emëruara në suazat e qeverisë janë në sferën e ndikimit të sajsi këshillat këshilldhënëse, komisione dhe komitetet dhe anëtarët e emëruar ose të deleguar. Në këto organe gratë fare pak kanë qenë të përfaqësuara dhe nuk kanë pasur mundësi të ndikojnë në sferën e vendimmarrjes. Disa vende kanë miratuar vendime me të cilat do të arrijnë balancin gjinor. Varësisht nga përqindja aktuale e grave dhe burrave, të cilët qeveria i ka vendosur nëpër këto organe është bërë domosdoshme që për një afat të caktuar të bëhen ndryshime në balancin gjinor. P.sh. në Britaninë e Madhe qeveria është angazhuar për zmadhimin e përqindjes së grave në këshillat e organeve publike, 34% janë gra dhe pritet që deri në fund të vitit 2005 gratë të jenë të përfaqësuara 45 % deri 50 % në këto pozita (për informata më të hollësishme shikoni në Shtesën 1).

27. Disa qeveri, poashtu, punojnë në mënyrë aktive për zmadhimin e numrit të grave të cilat janë të emëruara në vendet publike në nivel nacional duke shfrytëzuar sistemin të caqeve (shikoni shembullin në Shtesën 2)

#### Paragrafi 7

28. Edhe pse qeveritë luajnë rol vital në promovimin e balancit gjinor në sjelljen e vendimeve në jetën politike dhe publike, këtu janë të kyqur edhe "lojtarët" tjerë. Siç është përshkruar në rekomandim, parlamentet kombëtare, qeveritë lokale dhe regjionale, partitë politike, shërbimet qytetare, organizatat publike kuazi-publike, ndërmarrjet, sindikatat, organizatat e punëdhënësve dhe OJQ-t janë "lojtarët" kryesorë në këtë fushë dhe kanë përgjegjësi të veçantë lidhur me këtë. Prandaj është me rëndësi që rekomandimi të publikohet para të gjitha organeve relevante në shoqëri (shikoni Kreun C nga Shtesa e rekomandimit).

#### Paragrafi 8

29. Nevoja për vëzhgim është kryesore për implementimin e rekomandimit dhe në këtë rast qeveritë kanë rol shumë të madh. Vëzhgimi kërkon nga qeveritë rregullisht të sigurojnë informata statistikore të ndara në bazë gjinore ku do të vërehet pjesëmarrja e grave dhe burrave në vendimmarrjesi dhe do të vlerësohet përparimi në këtë aspekt në nivel kombëtar. Kreu Ci rekomandimit përmban propozime konkrete për përcaktimin e përparimit.

30. Vendet të cilat e ratifikuan konventën e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, në mënyrë ligjore janë të obliguara që t'i zbatojnë këto dispozita. Ata, poashtu, janë obliguar të dorëzojnë raporte kombëtar çdo katër vjet për masat e ndërmarra në pajtim me dispozitat e marrëveshjes. Kjo I kyq edhe masat të cilat sigurojnë kyqje dhe mundësi të barabarta të grave në jetën politike dhe publike dhe të drejtën e saj aktive dhe pasive për të votuar.

31. Në Konferencën e 4 Ministrave të Evropës për barazi gjinore (Stamboll 1977) ministrat u pajtuan për një diapazon të strategjive multidisiplinare, të cilat do të sigurojnë barazi gjinore në jetën politike dhe publike. Ojesë nga puna e Komitetit drejtues të Këshillit të Evropës për barazi gjinore e kyq edhe përgatitjen e një studimi dhe mbledhjen e të dhënave për pyetje të lidhura me barazinë gjinore në vendet anëtare. P.sh. rregullisht plotësohet dokumenti I cili përmban statistikë dhe numra për gratë që janë në pozita në qeveri, përqindjen e grave të zgjedhura në pozita në nivel kombëtar, regional dhe lokal dhe masat të cilat duhet të merren për t'i ndihmuar gratë të kyqen në jetën politike.

UKSE drejtpërsëdrejti I raporton Komitetit ministrave andaj rol të rëndësishëm mund të ketë në diseminimin e informatave dhe statistikave duke e përdorur edhe internetin.

### 3 Shtesë e rekomandimit Prezentim

32. Pjesëmarrja e barabartë e grave dhe burrave në sjelljen e vendimeve politike dhe publike në rekomandim është definuar me përfaqësim minimal prej 40% të secilës gjini në secilin organ vendimmarrës të jetës politike dhe publike. Minimumi I 40 % është në përputhshmëri me rezolutën e Parlamentit evropian, 18 Janar 2001 për pjesëmarrjen dhe barazinë e gjinive në vendosje.

33. Është e qartë se jeta politike dhe publike janë të lidhura dhe varura mes veti. Vendimet të cilat kanë të bëjnë me jetën e individëve dhe grupeve në shoqëri miratohen në këto sfera. Natyra e këtyre vendimeve drejtpërsëdrejti ka pasojë afatgjatë për shoqërimet, grupet, dhe individët. Ashtu sikur "Arenat" e vendosjes politike dhe publike, të cilat së bashku e përbëjnë infrastrukturën udhëheqëse është me rëndësi që të kujdesemi se sa janë të përfaqësuara në këto sfera interesat e grave. Në nivel fundamental pjesëmarrja e grave në jetën politike dhe publike dhe në vendimmarrje tani për tani është indikator I demokracisë në shoqëri. Vitet e kaluara, është shënuar një përparim modest lidhur me zmadhimin e pjesëmarrjes së grave në jetën politike në disa vende anëtare të Këshillit të Evropës. Për fat të keq e njëjta nuk mund të konstatohet për vendosjen publike përveç në disa vende të Evropës.

Roli I rëndësishëm I organizatave nërkombëtare dhe I parlamenteve përmes qeverisë e zmadhuan rolin dhe autoritetin e sektorit publik në nivel kombëtar, prandaj pjesëmarrja e grave në jetën politike dhe publike do të jetë shumë e rëndësishme.

34. Për qëllimin e këtij rekomandimi është e qartë se vendosja politike dhe publike është aktivitet I atyre personave ose anëtarëve të zgjedhur ose të emëruar në



pozita politike ose publike. Politikanët të cilët sjellin vendime kanë pozita në qeveri ose mund të jenë këshilltarë në qeveri. Politikanët të cilët sjellin vendime kanë eksperiencë si anëtarë të partive të tyre politike. Vendimmarrja publike është e cënuar me vendosjen e ndikimit mbi prioritetet e politikës publike. Personat të cilët sjellin vendime publike janë në qeveritë në pozita më të larta në gjyqësi, janë diplomatë me përvojë, liderë në profesionet e tyre, poashtu ata janë persona të cilët kanë pozita në suaza të ndërmarrjeve, shoqatave të cilat sigurojnë shërbime publike si dhe në pozita udhëheqëse në suaza të sindikatave dhe organizatave punëdhënëse.

#### A. Masat ligjdhënëse dhe administrative

Në këtë kapitull janë dhënë disa rekomandime me qëllim që të arrihet qëllimi. Edhe pse lista nuk është e kompletuar ajo përfshin përdorimin e gjuhës, financimin e partive politike, kushtet e punës të përfaqësuesve të zgjedhur, emërimet publike dhe maqinërinë për barazi dhe trajnim. Hulumtimet kombëtare gjithashtu janë të rëndësishme për ta përkufizuar problemin në nivel kombëtar dhe do të jep kahje qeveritë se çfarë masa juridike dhe administrative duhet të miratohen.

#### Paragrafi 1

35. Paragrafi 1 është klauzalë gjenerale për legjislativën e cila përfshin veprimin pozitiv. Legjislativa e cila lejon të merren masa pozitive në sfera të ndryshme të shoqërisë do të ketë efekt të madh për promovimin e barazisë në jetën politike dhe publike. Kjo legjislativë duhet kyçë dispozita për përfaqësim ose zhvillim të mejnstrimingut gjinor në nivel politik dhe masa për veprim pozitiv, që të sigurohet barazia e vërtet mes gjinive.

36. Në shumë vende të Evropës, barazia gjinore është e paraqitur në kushtatutë si e drejtë themelore e njeriut. Kjo solli deri te një ndarje e kufizuar në sferën e vendosjes mes gjinive. Në dy vende evropiane Belgjikë dhe Francë paritë politike janë të obliguara me ligj që ta respektojnë paritetin mes kandidateve në zgjedhjet politike ( shikoje Shtesën 3 ).

37. Shembulli I Francës veçanërisht është interesant kur bëhet fjalë për ndryshime kushtetutare. Ndryshimi I kushtetutës në vitin 1999 I mundëson Parlamentit të miratojë ligje të cilat përmbajnë masa pozitive të veprimit dhe të njëjtat smund të cenzurohen nga Këshilli kushtetues siç ka qenë më parë.

38. Në bazë të këtij shembulli qeveritë duhet të mendojnë për ndryshime ligjore dhe/ose kushtetuese me qëllim që ta ndihmojnë përfaqësimin e barabartë gjinor.

#### Paragrafi 2

39. Gjuha, simbolika e cila është e rëndësishme, zduhet t'i përkushtohet hegjemonisë mashkullore. Gjuha në mënyrë gjinore duhet të jetë neutrale ( p.sh. „ person ” ) kjo fjalë duhet të jetë për të dy gjinitë ( i tij / e saj ). Komiteti I ministrave të Këshillit të Evropës që në vitin 1990 e miratoi rekomandimin No\_R ( 90 ) 4 për eleminimin e seksizmit në gjuhë. Një evolucion për eleminimin e seksizmit në gjuhë mund të vërehet kur do të krahasohen në një anë konventa evropiane për të drejtat e njeriut dhe në anën tjetër Shtesa për të drejtat fundamentale të unionit evropian. P.sh. në EKÇP sistematikisht përemri pronor „ I tij ” është zëvendësuar me I tij / e saj.

40. Në Francë kryeministri lëshoi një cirkular ( 8 mars 1998 ) me të cilin thirren ministrat të përdorin tituj, emra, profesione, pozita edhe për gjininë femërore. Më 1993 Qeveria e Zvicrës vendosi se administrata duhet të përdorë gjuhë joseksiste; për gjuhën gjermane, kancelari lejoi të botohet „ Leitfaden zur sprachishen Gleichbehandlung im Deutchen ” ( Bern 1996). Prej vitit 2001 Ausria ka marrëveshje me ministrat për përdorimin e gjuhës në mënyrë gjinore. Në Gjermani në pajtim me ligjin federal për barazi gjinore ( I cili hyri në fuqi më 5.12.2001 ) thuhet se duhet pasur kujdes gjatë korrespondencës oficiale të përdoret gjuha në mënyrë gjinore.

### Paragrafi 3

41. Termi „ largësi e paritetit ” është e përkufizuar me raportin e grupit të ekspertëve të Këshillit të Evropës për barazi dhe demokraci si: „ Dispozitë ligjore / statutare e cila e pasqyron rregullën e paritetit p.sh. nga secila gjini në përbërjen e organeve konsultative të shtetit ( këshille, komisione grupe punuese etj.) në strukturat politike, sindikata, mediumet etj.

42. Ndryshimet ligjislative duhet të bëhet në ligjrt zgjedhore për ato lokale, regjionale dhe nacionale, me qëllim që të sigurohet barazi gjinore, e cila do të garanton 40 % të vendeve jo për secilën gjini por 40 % të zgjedhur nga secila gjini. Me sistemin zipër ( cik – cak ). Ku në listat zgjedhore secili kandidat I dytë do të jetë femër.

### Paragrafi 4

43. Ky paragraf ka të bën me finarizimin publik të partive politike si dhe si mund të shfrytëzohet kjo për tu inkurajuar ato që ta promovojnë barazinë gjinore. Në disa vende është e nevojshme që të ketë masa ligjislative kurse në disa mjaftojnë masa administrative. Mjetet financiare mund të merren nga buxheti shtetëror me shënim për barazi gjinore ose pa ndonjë fond specil enkas për këtë qëllim. Dallimi mes shteteve se sa mjete financiare mund tu jep partive politike për këtë qëllim është nga mundësia e

shtetit për të ndarë mjete andaj duhet të përmbahen qeveritë që ato të të mundën të ndajnë mjete për këtë, ose të përmbahet partoa politike ose sektori I grave.

44. Shfrytëzimi I kësaj përmbajtje financiare gjithsesi dallohet prej vendi në vend. Kësisoj shembulli janë programet për trajnime dhe liderë si dhe programet për ngritjen e ndërgjegjes ( shiko masat e ndryshme të propozuara në paragrafet 20, 21, 22 ). Është e qartë se partitë politike skanë përkrahje financiare për kësisoj aktivitete, prandaj duhet caktuar një vlerë e caktuar financiare për këtë përkrahje.

45. Shembull për përkrahje financiare të partive politike është Franca. Ligji nga 6.VI.2000 për barazi gjinore deri në vendet e të zgjedhurve kyq edhe dispozitën për dënime me të holla për partitë të cilat s'do të mund të paraqesin 50 % të kandidatëve nga secila gjini.

46. Për zgjedhjet parlamentare, për të cilat metoda e votimit ( sistem I kombinuar zgjedhor ) s'mund të garanton paritet në suazat e çdo konstituimi, ligji bën zvogëlimin e mjeteve financiare të partisë, nëse dallimi gjinor I kandidatëve e kalon 2 % nga numri I përgjithshëm. Kurse partitë që do të prezentojnë 29 % femra dhe 51 % meshkuj s'do të dënohen.

47. Zvogëlimi s'guxon të kalojë 50 % nga ajo shumë të hollash. P.sh. nëse partia prezenton vetëm 45 % gra, dallimi është 10 % ( 45 / 55 ) dhe finasimi I saj publik do të zvogëlohet për 5 %. Me këtë mekanizëm largohet efekti I dallimit gjinor.

## Paragrafi 5

48. Qëllimi I paragrafi 5 që të ceket se hulumtimet dhe statistikak kanë treguar se atje ku ka sisteme proporcionale të përfaqësimit, gratë më lehtë mund të jenë më shumë të përfaqësuar në organet politike. Gjatë tri dekadave të kaluara kishte rritje të dukshme të përfaqësimit të femrave, atje ku ka sisteme proporcionale, kurse përparim më I vogël është arritur atje ku ka sistem të shumicës. Kjo si duket ka të bën me atë se atje ku ka vetëm një kandidat, si është rasti cili I pari në pozitë, obligimi është faktori kyq për zgjedhjen e kandidatit, kurse sot në të shumtën e rasteve kështu soj kandidatë janë burra dhe është shumë vështirë që këto vende t'u jepen grave. Kjo mund të jetë problematike atje ku listat I përpilon partia, e cila pret të fiton disa vende në secilën njësi zgjedhore.

49. Kufizimet gjeografike në të cilat realizohen zgjedhjet, mund të kenë ndikim se a përfaqësimi proporcional ose sistemi I një anëtari shpien kah përfaqësimi I barabartë I të dy gjinive. Nëse sistemi proporcional është „ lokal ” d.m.th. I vendosur në një hapsirë të kufizuar gjeografike, mund të jetë pengesë për gratë sikurse edhe sistemi I një anëtari. Kështu ishte rasti në Francë gjatë zgjedhjeve parlamentare në vitin 1986 ku është shfrytëzuar sistemi proporcional në nivel të çdo departamenti. Edhe pse kishte më shumë gra kandidate ( 24.7 % krahasuar me 11.9 % nga viti 1981 kur ishte aplikuar sistemi një anëtar ) numri I grave të zgjedhura ishte shumë I ulët ( 5.9 % krahasuar me 5.3 % më 1981 ). Sistemi në bazë të departamenteve ju dha një përparësi kandidatëve me një

përkrahje solide lokale dhe kandidatët të cilët kishin mbledhur një vend ( p.sh. kombinimi I funksioneve anëtar I parlamentit, prefekt, këshilltar ). Në këto rrethana është më rëndë që liderët t’I venë gratë autsjdere në pozita se sa kur aplikohet sistemi proporcional ( siç është rasti me sistemet zgjedhore evropiane ). Të gjitha ndryshimet dhe adoptimet duhet të jenë të bazuara në hulumtimet lidhur me këtë çështje.

## Paragrafi 6

50. Në disa vende evropiane aktiviteti I marrjes me politikë ka tendenca të profesionalizimit. Kjo do të thotë shumë pak politikanë kanë kuazitë thotë kuazimonopol, duke e parandaluar kështu kyqjen e grave në politikë. Këta politikanë shpesh herë janë në disa pozita njëkohësisht. Kështu një politikan „ profesionist ” në të njëjtën kohë mund të jetë prefekt, anëtar I parlamentit ose I qeverisë.

51. Fakti se personi I njëjtë ka disa pozita në të njëjtën kohë e parandalon përrirjen në politikë, dhe është pengesë për pjesëmarrjen e të dy gjinive në vendosjen politike e publike. Si duket kjo dukuri gjithnjë e më shumë është jokompaktibile me zhvillimin e demokracisë. Demokracia moderne gjithnjë e më tepër cek se duhen të kyqen numër sa më I madh nga sektori shoqëror në atë politikë. Dhe kufizohet numri I pozitave që mund të mbahen njëkohësisht që automatikisht mundëson pjesëmarrje më të madhe, si domos të grave.

52. Andaj qeveritë duhet t’I marrin parasysh masat përkatëse ligjore, pasi do të bëhen hulumtimet lidhur me situatën aktuale në shoqëri. Ministrat, të cilët morën pjesë në konferencën e 4 ministrove në Stamboll 1997 u pajtuan me këtë princip dhe ju propozuan partive politike që t’I kenë parasysh këto masa, është me rëndësi se qeveritë seriozisht janë duke menduar se ku është e nevojshme të aplikojnë kësaj kufizime ligjore.

## Paragrafi 7

53. Ky është nen I cili e protencon rëndësinë e përmirsimit të kushteve të punës të të zgjedhurve në nivel lokal regional nacional dhe sub – nacional. Edhe pse të zgjedhurit sub – nacional nuk kanë ndikim direkt për punët brenda,ata mund të propozojnë masa të cilat duhet të merren në nivel lokal,regjional dhe nacional.Edhe pse aktivitetet politike shpesh herë marrin shumë kohë,kompenzimi financiar është shumë I ulët.Në shumë raste puna politike, në nivel lokal është më tepër si punë volontere se sa punë e paguar.Është e njohur aktivitetet politike lokal duhet në mënyrë përkatëse të kompenzohet dhe të përmirësohet gjendja financiare e politikanëve lokalë.

54. Qeveritë duhet të mendojnë për këtë dhe të miratojnë legjislativë përkatëse dhe të sigurojnë kushte të punës në politikë të ngjajshme me ato në tregun e punës.Kjo duhet të nënkupton p.sh. kompenzim financiar,të drejtë për pension, konvokimi I

mbledhjeve të jetë në harmoni me jetën familjare. Këto masa do të bëjnë që jeta politike të jetë obcion real si për femrat ashtu edhe për meshkujt.

## Paragrafi 8

55. Personat me obligime familjare shpesh mund të hamenden që të kyçen në organet politike për shkak se ndodhin ndryshime në kushtet e punës. Ata mund të ndodhë që të transferohen, ta lëshojnë vendin e tyre të punës pa garancë se prap mund të kthehen aty, poashtu mund ta humbin të drejtën për personin për tre ose katër vite. Poashtu parlamentarët nuk e kanë gjithmonë të drejtën për pushim prindor ( kur lind fëmi ). Rëndom gratë kanë pozita më të ulta në shoqëri dhe më shumë obligime familjare, dhe mungesa e legjislativ për t'iu mundësuar shërbime logjistike ( kujdesi për fëmijë etj.) mund të kontribuojë që gratë më vështirë të vendosin të merren me politikë, se sa burrat.

56. Në anën tjetër adoptimi i kushteve për punë të personave të zgjedhur me kushtet e jetës bashkëkohore gjithësesi do të jenë të volitshme edhe për burrat politikanë. Këto masa mund të kyçin jo vetëm pushim të nënave por edhe pushim të baballarëve.

57. Pjesa e parë e paragrafit është e përqëndruar në rëndësinë e masave ligjdhënëse të cilat duhet marrë dhe roli që duhet pasur për miratimin e atyre. Pjesa e dytë është përqëndruar në kushtet e punës në kornizat e Parlamentit evropian, parlamenteve nacionale, dhe pushtetit lokal dhe regjional. Duke mbajtur llogari për orarin e punës, kohëne mbajtjes së mbledhjeve dhe harmonizimin e punës në politikë dhe obligimeve familjare do të jepet kontribut i madh për pjesëmarrje të shtuar të të dy gjinive në jetën politike.

58. Rëndësia e masave të cilat duhet të merren në këtë fushë është theksuar në disa konferenca të Këshillit të Evropës. Ato janë përpunuar në Rekomandimin e Këshillit të Evropës No. R (96) 5 për harmonizimin e kushteve të punës dhe jetës familjare, veçanërisht Principi 5 dhe në tekstet të cilët dolën nga Konferenca e 4 ministrave për barazi gjinore ( Stamboll 1997 ) dhe Konferenca e 27 ministrave të Evropës për punë familjare, e mbajtur në Slloveni në qershor 2001.

## Paragrafi 9

59. Argumentet kryesore për përfaqësim të barabartë gjinor në komitetet publike janë këto. Kur qeveritë punojnë në krijimin e politikës / ndryshime ligjdhënëse në fushë specifike ata shpesh herë thirrën në organizata të ndryshme dhe institucione për emërim të përfaqësuesve të tyre. Qëllimi është sigurimi i duhur i diturisë dhe eksperiencës si dhe sigurimi i konsensusit social të pyetjes. Kjo pyetje në mënyrë ekstensive është dhënë në raportin e Këshillit të Evropës për veprimin pozitiv në fushën e barazisë gjinore.

60. Përvoja ka treguar se procedura e emërimeve publike shpesh herë është diskriminuese ndaj burrave dhe organet shpesh paraqiten me kandidat mashkull që do të thotë se kur vendosen komitetet, qeveria ska zgjedhje dhe duhet ta emërojë këtë person.

61. Me qëllim që t'i dalin në krye këtij fenomeni dhe të sigurojnë barazi gjinore në organet e emëruara, këshillë të ndryshëm disa vende kanë miratuar legjislativë të veçantë. Ndër të parat këtë e bëri Norvegjia, Danimarka dhe Finlanda poashtu kanë miratuar legjislativë në këtë fushë ( shiko shtesën 4 ).

62. Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave e OKB – së ( 1979 ) lejon marrjen e masave speciale në këtë fushë ( shih Nenet 4 dhe 7 ). Deklarata e Stambollit e thekson rëndësinë e barazisë gjinore në të gjitha komitetet dhe ju rekomandon qeverive që ta miratojnë dhe të implementojnë masa ligjdhënëse dhe / ose administrative me qëllim të sigurojnë barazi gjinore për të gjitha emërimet prej ministrit e deri te komitetet publike.

#### Paragrafi 10,11,12

63. Këto paragrafe janë të përqëndruara në rolin e shtetit si punëdhënës dhe përfaqësues politik I njerëzve. Qeveritë kanë rol të dyfishtë si dhe obligim të promovojnë barazi gjinore. Ato kanë, si shtete të pavarura që marrin pjesë në bashkësinë ndërkombëtare, nënshkruar dhe ratifikuar marrëveshje ( konventa ) të cilat kanë qasje INTER ALIA lidhur me barazinë gjinore. Ato kanë miratuar edhe disa rekomandime, programe, plane për veprim. Konventa SEDAV dhe Platforma për veprim e Pekinit duhet veçanërisht të ceket. Shtetet kanë obligim ligjor të sigurojnë implementimin e këtyre instrumenteve ndërkombëtare në sektorin publik dhe privat. Shtetet janë punëdhënësit më të mëdha dhe të rëndësishëm për femrat. Vendimet që sjell shteti si punëdhënës janë shembull për punëdhënësit tjerë. Në këtë kuptim qeveritë duhen të jenë shembull për punëdhënësit.

64. Me këto paragrafe shtetet ftohen të marrin masa për t'i promovuar gratë në pozita vendimmarrëse me qëllim të sigurimit të barazisë. Propozimet e dhëna për preventivë ndaj diskriminimit të mundshëm në procesin e selektimit në pozita udhëheqëse, përparim në karrierë etj. duhet të jenë transparente dhe më demokratike. Gjyngji I Drejtësisë në bashkësitë evropiane në mënyrë permanente thekson aplikimin e transparencës në procedurat e punëdhënësve si pjesë shumë e rëndësishme në promovimin e barazisë gjinore.

65. Masat e propozuara mbështeten në Platformën për veprim të Pekinit 1955 si dhe përfundimet e Sesionit Special të Asamblesë së OKB-së të v.2000 dhe Deklaratës së Stambollit nga Konferenca e 4 ministrorë 1997. Ata e theksojnë rolin e dyfishtë të shteteve që e kanë si punëdhënës dhe shtete me përgjegjësi politike.

### Paragrafi 13

66. Burrat dominojnë në përbërjen e delegacioneve dhe organizatave ndërkombëtare në disa raste ato delegacione janë pastër mashkullore. Edhe vendimet e miratuara në nivel evropian dhe ndërkombëtar kanë ndikim më të madh se më oarë dhe kanë tendencë të ndikojnë mbi njerëzit direkt, andaj është me rëndësi ato të kenë përbërje dy gjinore.

67. Disa instrumente ligjore ndërkombëtare, rregulla dhe urdhëresa tanimë përmbajnë dispozita për këto efekte por nuk imlementohen në mënyrë adekvate.

68. Neni 8 SEDAV thotë se shtetet palë do t'i ndërmarrin të gjitha masat për t'u siguruar se gratë njësoj si burrat pa asçfarë diskriminimi do të kenë mundësi ta përfaqësojnë qeverinë e vet në nivel ndërkombëtar dhe të marrin pjesë në punën e organizatave ndërkombëtare.

69. Plotësim Neni 4 I SEDAVË lejon masa të përkohshme speciale nga ana e qeverisë me qëllim të shpejtësohet DE FAKTO barazia gjinore.

70. Shtesa e Kongresit e pushtetit lokal dhe regional në Evropë dhe Këshillit të Evropës thotë se Anëtarët e çdo delegacioni vend – anëtare në KLRVE duhet përkatësisht të sigurohet përfaqësim I barabartë I femrave dhe meshkujve.

### Paragrafi 14

71. Në delegacionet shtetërore janë fare pak prezente. Mungesa e barazisë gjinore në negociata dhe në komitetet për negociata, veçanërisht në proceset për paqë dhe ato për zgjidhjen e konflikteve është shqetësuese. Veçuar Nenin 8 nga SEDAV, gratë pothuajse asnjëherë nuk janë prezente në tavolinat e bisedimeve negociatore. Akoma gratë vuajnë nga konfliktet e armatosura si edhe burrat, mos edhe më shumë. Gratë janë shumë aktive në lëvizjet për paqë në regjionet e përfshira nga konfliktet dhe në mënyrë aktive marrin pjesë në periudhën paskonfliktuoze dhe në restaurimin e shoqërisë. Për këtë ato duhet ta gjejnë vendin e vet në negociata dhe pikëpamjet e tyre të merren parasysh kur bëhet fjalë për paqën dhe zgjidhjen e konflikteve dhe rekonstruimi I shoqërisë. Qeveritë pikërisht për këtë duhet të mendojnë për përmirsimin e barazisë gjinore kur emërojnë përfaqësues për negociata ndërkombëtare dhe komitete për negociata.

72. Komiteti drejtues për barazi gjinore pranë Këshillit të Evropës, organizoi seminar për pjesëmarrjen e grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, në shtator 2001. Qëllimi I seminarit ishte të inicohen diskutime për pyetje të ndryshme lidhur me gratë, aktivitetet e tyre në post – konfliktet dhe ato për paqë dhe rikonstruim. Gjithashtu roli I seminarit ishte për ta përgatitur Konferencën e 5 ministrorë për barazi gjinore ( Shkup 22 – 23 janar ) tema e të cilës ishte „ Dmokratizimi, parandalimi I konflikteve dhe ndërtimi I paqes: perspektiva dhe roli I grave ”.

Pjesëmarrësit në seminar I paraqitën rekomandimet e veta duke e theksuar rëndësinë e INTER ALIA për vendosje të barabartë gjinore në të gjitha nivelet e shoqërisë, duke I kyqur këtu mekanizmat për ndalimin e konflikteve, shërbimet diplomatike dhe ato ku mirren vendime për paqë dhe për luftë.

#### Paragrafi 15

73. Kuptim I këtij rekomandimi është se gratë shpesh herë kanë pozita më të dobta në tregun e punës. Në të njëjtën kohë ato e përbëjnë edhe shumicën p.sh. në profesionet si mësuese dhe motra medicinale. Punëdhënësit për këtë duhet të mendojnë se çfarë masa nevoiten që gratë të mundën bukur t’I shfrytëzojnë të drejtat e veta qytetare dhe mos ta humbin të drejtën e tyre për punë nëse duan të marrin pjesë në politikë ose jetën publike. Në këtë paragraf janë përfshirë edhe pjesëmarrja në politikë dhe organet vendimmarëse edhe pse në paragrafin paraprak janë në mënyrë më relevante.

74. Në disa vende – anëtare egzistojnë rregulla për të drejtat e të punësuarve për të shfrytëzuar pushim pa pagesë për të punuar në organizata ndërkombëtare. Rregullat e paraqesin procedurat mes punëdhënësit dhe punëtorin dhe e përcaktojnë periudhën gjatë së cilës I punësuar mundet ta ruajë punën që e ka pasur më parë. Rregull tjetër që egziston në disa vende anëtare i paraqet të drejtat të punësuarve të zgjedhur në pozita të sindikatës, ata mund të marrin pushim nga puna pa pasoja. Rregullat të ngjajshme të cilat garantojnë të drejtën për pushim pa dënime për të punësuarin për shkak të obligimeve të saj / tij me votimet s’do të jenë të favorshme vetëm për gratë por edhe për burrat. Po ashtu këto rregulla në mënyrë gjenerale mund ta ndihmojnë pjesëmarrjen e barabartë të gjinive në jetën politike.

#### Paragrafi 16

75. Shumica e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës kanë vendosur një lloj maqinerie nacionale për promovimin e barazisë gjinore. Në doracakun e maqinerisë nacionale të Këshillit të Evropës i botuar në maj 2001, maqineria nacionale është përcaktuar si institucionale dhe e qeverisë, në disa raste, struktura parlamentare e vendosur për ta promovuar avancimin e gruas dhe të drejtat e saj. Kjo strukturë kryesisht vëzhgon dhe përcjell implementimin e ligjit dhe principet e barazisë gjinore.

76. Rëndësia e kësaj maqinerie nacionale në fushën e barazisë gjinore në nivel më të lartë në suazat e qeverisë është theksuar edhe në Platformën e veprimit në Peking dhe Marëveshjet dhe përfundimet e sesionit special të Asamblesë në qershor të vitit 2000, me një revizion të përparimit pos Pekingut. Maqineria nacionale luan rol në informimin e opinionit më të gjerë për rëndësinë e kësaj barazie si dhe pengesat në të cilat hasin femrat. Maineria nacionale shpesh ka njohuri dhe ndikimi i tyre në shoqëri dhe masa të ndryshme të propozuara në rekomandim janë shembuj për projekte të cilat qeveritë mund



t'ia besojnë maqinerisë nacionale. Këto maqeneri shpesh herë nuk kanë mjete financiare andaj qeveritë duhet t'i përkrahin në përpamje financiare t'i ekipojnë me qëllim që barazia gjinore të jetë sa më e madhe në vendosje.

#### Paragrafi 17

77. Në disa vende – anëtare të Këshillit të Evropës janë themeluar komisione të veçanta parlamentare ose delegacione për të drejtat e grave dhe për mundësi të njëjta. Këto komisione ose delegacione janë mehanizëm i lëndësishëm për promovimin e barazisë gjinore dhe me instrimungun e kësaj barazie në legjislativën kombëtare dhe krijimin e politikës në suazat e parlamentit ( shih shembuj në Shtesën 5 ).

78. Paragrafi nuk u drejtohet vetëm parlamenteve nacionale. Delegacionet parlamentare dhe komitetet në nivel lokal, regional dhe subnacional janë shumë të rëndësishme (shih Shtesën 5).

Në suazat e kuvendit parlamentar të Këshillit të Evropës egziston Komitet për mundësi të njëjta mes meshkujve dhe femrave. Në rekomandimin 1413 ( 1999 ), Kuvendi parlamentar rekomandon që delegacionet nacionale të bëjnë shtypje që parlamentet të vendosin kështusoj komitete ose delegacione në suazat e parlamenteve nacionale. Për këtë paragrafi 17 i fton qeveritë të mendojnë për përkrahjen e propozimeve në nivel ndërkombëtar dhe i inkurajon pushtetet regjionale dhe lokale për themelimin e këtyre komiteteve.

#### B.Masa për mbështetje

Në këtë pjesë janë propozuar masa të cilat drejtpërsdrejti mund të implementohen me përkrahje të organizatave të grave ose organizatave të tjera që promovojnë barazi gjinore.

#### Paragrafi 18

79. Ky paragraf paraqet rekomandim gjeneral për qeveritë që me të gjitha mjetet që i kanë në disponim t'i përkrahin prganizatave e grave dhe organizatat që punojnë për barazi gjinore me programe që stimulojnë pjesëmarrje të barabartë në vendimet politike dhe publike. Me decenie, organizatat e grave dhe organizatat tjera që punojnë për barazi gjinore janë subjekte të rëndësishme për promovimin e barazisë gjinore në shoqëri dhe të njëjtat e kanë justifikuar veten.Përvoja që kanë,lidhjet, shpeshherë partiake janë shumë të dobishme kur përcaktohen dhe implementohen projekte lidhur me këtë problematikë.Sidoqoftë, këto organizata shpeshherë kanë probleme financiare dhe mangësitë ekepeve që të munden me sukses t'i implementojnë aktivitetet e veta.Qeveritë duhet të mendojnë për t'i përmbajtur me financa dhe t'i inkurajojnë në punën e tyre.Kjo është theksuar në Konferencën e 4 ministrorë të Evropës për barazi gjinore,Stamboll 1997.

80. Unioni Evropian është I interesuar për përfaqësim të barabartë në jetën politike sidomos prej miratimit të Programit të tretë të veprimit për mundësi të njëjta ( 1991 – 1995 ).Programet e veprimit të BE kycin edhe masa për përkrahje të OJQ femërore të cilat e kanë justifikuar punën e tyre.Shembull tjetër shumë I rëndësishëm është edhe projekti „Gratë mund t’ia arrijnë ” i financuar nga qeveria norvegjeze dhe është implementuar në shumë vende nga Grupi punues për barazi gjinore në Paktin për Stabilitet të Evropës Jug – Lindore.

#### Paragrafi 19

81. Qëllimi I këtij paragrafi është që të merret me argumentin shumë të përdorur „ Gratë nuk duan të marrin pjesë në vendimmarrjet në politikë dhe jetën publike ”. Një bazë e tillë faktesh do t’iu mundëson partive politike dhe institucioneve tjera me një bazë solide të kenë mundësi t’I identifikojnë gratë, të cilat duhet të angazhohen në politikë. Deklarata e Stambollit propozon të propozohet një veprim I ngjashëm nga qeveritë.

82. Atje ku ka bazë shënimesh është treguar se janë tejet të dobishme për promovimin e grave në jetën politike dhe publike. Arsyetimi i cili shumë shpesh përdoret kur burrat promovohen ose kandidohen në komitetet qeveritare ose këshillat, janë se s’mund të gjendet femër me përgatitje shkollorëe përkatëse dhe përvojë të duhur.Burri I cili promovohet ose kandidohet është I vetmi me shkollimin përkatës dhe e ka përvojën e duhur. Në këto raste baza e shënimeve do të luante rol të madh për t’I zbuluar gratë kandidate potenciale dhe kështu do të bëhej zmadhimi I numrit të grave kandidate. Andaj ju rekomandohet qeverive në mënyrë aktive të komunikojnë me këto rrjeta bazash me shënime. Sidoqoftë që këto baza të jenë efektive ato duhet të shfrytëzohen si burim I qeverisë kur ajo bën emërimë, këto aktivitete janë shembull I mirë për projekt të cilin qeveria mund t’ia beson OJQ të femrave ose maqinerisë nacionale. Prej para një kohe në Norvegji ekziston një projekt I këtillë ( shih shtesën 6 ).

#### Paragrafi 20

83. Gratë përfaqësuese të zgjedhura shpesh punojnë së bashku në rrjetat inter – partiake p.sh. në parlamentet nacionale. Kjo është me rëndësi kur bëhet fjalë për analizën e procesit bugjetor nga aspekti gjinor. Rrjetëzimi I grave të zgjedhura edhe në pozitë ( ministre, deputete, këshilltare lokale, regjionale ) duhet t’iu mundësohet në nivel evropian veçanërisht se më shumë e më shumë gra politikane ballafaqohen me më problemet si tregëtia me gra dhe dhuna permanente mbi gratë. Si gra ato duan të bisedojnë për këto probleme pa marrë parasysh opcionet e tyre politike. Kjo nevojë është e diskutuar në disa konferenca dhe seminare të organizuar nga Këshilli I Evropës. Rrjetat e grave evropiane deri në një nivel edhe ekzistojnë p.sh. në suazat e organizatave si këshilli I komunave evropiane dhe regjioneve dhe Lidhja ndërkombëtare e pushtetit lokal.

Bashkimi joformal poashtu është I rëndësishëm. Këshilli I grave lidere botërore, dhe organizatat tjera kanë organizuar mbledhje dhe seminare për gratë në politikë në organet vendimmarrëse, është me rëndësi se qeveritë janë duke I përkrahur këto aktivitete.

## Paragrafi 21

84. Ky paragraf përqendrohet në gratë të cilat mendojnë për hyrje në jetën politike dhe publike. Qëllimi I paragrafit është të theksojë se ligjdhënësve kombëtar duhet t'u jepet me dije se ç' do të thotë të marrësh pjesë në vendosjen politike dhe publike. Shumë njerëz hynë në këto detyra pa e ditur se si ato funksionojnë dhe çfarë shkathtësi duhen. Kjo është e saktë sidomos për gratë, nëse mirret parasysh pjesëmarrja e tyre e mëvonshme në jetën politike. Është me rëndësi për gratë të cilat kyçen në politikë të kenë bazë për atë se ç' është politika të njohtohen me programet për punë „ në hije ” programet për medime, trajnime etj. Kështu ato do të jenë të përgatitura për kërkesat dhe detyrat që do të parashtrihen para tyre. Fuqia e medimeve është e madhe dhe e rëndësishme, andaj gratë – kandidatet duhet të dijnë si t' I shfrytëzojnë ato dhe t' I paraqesin para tyre mesazhet deri te zgjedhësit e vet. Këto masa mund të jenë të dobishme për gratë, të cilat do të jenë në pozita të larta të shërbimeve qytetare.

85. Paragrafi vazhdon me masa konkrete të cilat mund të merren me qëllim të angazhimit më të madh të grave në politikë dhe organet vendimmarrëse. Është me rëndësi se programet për përparim në karrierë kyçin planifikim të karrierës, fuqizimin e pozitës dhe zmadhimi I mundësive për të fituar pozita vendimmarrëse.

86. Programet për përparim në karrierë mund të shfrytëzohen edhe si veprime konkrete dhe pozitive për zvogëlimin e pabarazisë mes femrave e meshkujve në vendimet politike e publike. Pikëpamjet sociale, kulturore dhe tradicionale për shoqërinë, shpesh I ndalojnë gratë për t' I rrealizuar kapacitetet e tyre dhe njëkohësisht shoqëria është e hendikepuar për shkak të kontributit të kufizuar të grave.

## Paragrafi 22

87. Informacionet dhe teknologjia komunikative janë duke përparuar shumë shpejt dhe janë shumë të rëndësishme kur bëhet fjalë për vënien e kontakteve, komunikim dhe rrjetëzim. Kjo është valide në të gjitha nivelet e jetës politike para së gjithash në nivel lokal ku ka një ngecje të informacioneve dhe teknologjive moderne. Prandaj është shumë e rëndësishme që gratë – kandidatet për pozicione politike t' I kenë mundësitë e njëjta me burrat dhe të mësohen t' I shfrytëzojnë këto teknologji.

## Paragrafi 23

88. Njerëzit e rinj pa ndonjë mëdyshje e pranojnë se nuk ka probleme në barazinë gjinore në Evropë. Burrat e rinj mund të ndjehen të kërcnuar nga gra të reja me përgatitje të lartë shkollore sepse mendojnë se ato I marrin vendet të cilat janë të rezervuara për ato. Prandaj është me rëndësi që ata ta kuptojnë se pjesëmarrja e barabartë në politikë është e rëndësishme për përparimin e shoqërisë.

89. Siç është theksuar në Platformën e veprimit nga Pekini, mundësia e njëjtë për shkollim dhe kualifikim është e domosdoshme nëse gratë duan të bëhen bartëse të ndryshimeve. Në disa vende barazia për t'u shkolluar ende s'është në nivelin e duhur. Materialet për mësim akoma në aspektin gjinor nuk janë të senzibilizuara dhe të adaptuara p.sh. për nevojat e grave dhe vajzave. Kjo gjë I përforcon rolet tradicionale të meshkujve dhe femrave me çfarë e zvogëlon mundësinë për barazi dhe partneritet në shoqëri.

90. Popullata me doemos duhet të edukohet. Për një sistem demokratik njerëzit duhet t'i kuptojnë principet demokratike të vendosjes, t'i përmjnë dhe të marrin pjesë në sistem. Kjo do të thotë përvetësim diturish demokratike, me institucionet që e përmbajnë, rregullat që e drejtojnë sistemin politik dhe roli I secilit individ në suazat e atij sistemi, si historia bashkëkohore, të gjitha format e mësimi qytetar dhe arsimimi I popullatës. Prandaj shkollat duhet të sigurojnë shkollim të popullatës me prespektivë të zhvillimit dhe avancimit të njohurive me mundësi për t'iu përgjigjur ndryshimeve, zhvillim të partneritetit si parakusht për të shijuar demokracinë. Qytetarët e shkolluar dheshkollimi I qytetarëve janë ngusht të lidhur me krijimin e kulturës demokratike shkollore. Me arsimin ju mundësohet të rinjve që në të ardhmen të jenë bartës të ndryshimeve sociale. Mezhvillimin e projekteve të cilat ju japin mundësi të rinjve të marrin iniciativa dhe I stimulojnë për të fituar me njohuri më të mëdha dhe kështu vendosen lidhjet midis mësimi dhe botës reale gjë që I jep vlerë interesimeve të të rinjve që kanë të bëjnë me shoqërinë.

91. Arsimimi I popullit dhe populli I arsimuar duhet të përbëjnë pjesë të procesit shkollor dhe në mënyrë eksplicite t'i kyoçin pyetjet gjinore me qëllim të rritjes së interesit për pjesëmarrje të të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe të promovohen kushte për partneritet gjinor.

92. Ky arsim ka për qëllim një diapazon të madh ndryshimesh në procesin arsimor. Së pari, barazia së bashku me pyetjet tjera për demokracinë si dhe arsimimi për paqe, për obligimet qytetare në sektorin publik e privt, s'duhet të shikohen si pjesë shtuese, por ato duhet ta përbëjnë legjislativën e cila do të udhëheqë me sistemin shkollor. Këto qëllime duhet të arrihen dhe të integrohen në trajnimet e mësuesve të cilët s'mu'd të jenë të ndarë nga subjektet tjera dhe përvojat pedagogjike shkollore.

93. Shkolla s'është e izoluar nga shoqëria por ajo I përcjell modelet e saj. Shoqëria karakterizohet me diskriminim të grave dhe dominimin që e durojnë, edhe shkollat nënkuptohet se i reprodikojnë këto modele.

Mungesa e diskriminimit formal s'është e mjaftueshme që të sigurohemi se sistemi shkollor është DE FAKTO medium për barazi. Vetëm me promovimin e ko – edukatës real përmes sistemit arsimor mund të realizohet barazi mes të rinjve dhe të rejave duke I përgatitur të ballafaqohen me ardhmërinë dhe të bëhen qytetarë të denjë. Integrimi mi barazisë në të gjitha nivelet e sistemit shkollor është I domozdoshëm me qëllim që në mesin e të rinjve të promovohen vlera të drejtësisë dhe pjesëmarrje aktive në popullatë dhe partneritet midis gjinive në sferën private dhe publike. Kjo është akoma larg nga praktika e sistemit shkollor.

94. Zgjedhja që bëjnë të dy gjinitë lidhur me arsimimin, aktiviteti profesional stili I jetës, janë subjekt I fuqishëm dhe shtypje nën ndikim të stereotipeve mashkullore dhe femërore.

Ato kanë reperkusione për ndarjen e punëve dhe obligimeve në familje dhe ndarjen e roleve në tregun e punës dhe pjesëmarrjen e të dy gjinive në procesin e vendosjes në politikë. Arsimimi për barazi duhet të jetë pjesë qëndrore e popullatës demokratike.

#### Paragrafi 24 dhe 25

95. Partitë politike të Evropës ballafaqohen me mungesë të njerëzve të rinj. Gjithnjë e më pak të rinjë anëtarsohen në partitë politike dhe gjithnjë e më pak kanë rol aktiv brenda tyre. Kjo tendencë e kërcnon ripërtirjen e politikanëve.

96. Kjo nuk do të thotë se njerëzit e rinj nuk ndjehen të prekur nga problemet e shoqërisë. Të rinjtë, veçanërisht femrat gjithnjë e më shumë janë të orientuara të anëtarsohen në OJQ se sa në parti politike, për arsye se ato sigurojnë mënyrë më fleksibile për zgjidhjen e problemeve të cilat I tangojnë të rinjtë e për të cilat ato ndjehen të obliguar. Të rinjtë poashtu edhe në mënyra tjera e tregojnë interesimin për pyetje nga sfera e politikës dhe ajo publike, si pjesëmarrje në demonstrata nënshkrimi I peticioneve etj.

97. Sistemi arsimor formal, vet s'mund t'iu përgjigjet ndryshimeve të shpejta sociale, politike, ekonomike në shoqëri prandaj duhet t'I ndihmohet me praksë arsimore jo formale organizatat rinore janë burimet kryesore për ekspertizë në fushën e trajnimit jo formal dhe në këtë aspekt janë arritur suksese të dukshme.

98. Në organizatat rinore, të rinjtë kanë mundësi të zbulojnë, analizojnë dhe të mësojnë për vlerat dhe të ndërtojnë sistem të vetin të vlerave sipas të cilit do të udhëhiqen në jetë. Ata organizojnë kampe punuese, mbledhje, rekrutojnë vullnetarë, sigurojnë mjete, I mbikqyrin llogaritë në bankë, udhëheqin me personelin, ju japin përkrahje psikologjike shokëve, organizojnë aktivitete kulturore e sportive, veprojnë në shoqëri dhe llojnë për ndryshime sociale. Të gjitha këto aktivitete në OJQ ju mundësojnë të rinjve të përfitojnë përvojë në proceset demokratike, të vendosjes, përgjegjësisë dhe të liderit.

99. Edhe pse janë prezente në shoqatat, vajzat e reja shumë pak janë prezente në organet vendimmarrëse. Mendimet dhe nevojat e femrave mund të mos merren parasysh në përcaktimet e shoqatës. Atyre nuk u jepet mundësia të fitojnë eksperiencë për udhëheqje.

100. Pjesëmarrja e të rinjve, veçanërisht grave në shoqata duhet të promovohet dhe stimulohet. Organizatatb rinore duhetb të stimulohen që të sigurojnë pjesëmarrje të barabartë të dy gjinive në organet vendimmarrëse.

## Paragrafi 26

101. Bashkësitë etnike të minoriteteve dhe ardhacakëve shpesh janë të përfaqësuara vetëm me meshkuj, kur bëhet fjalë për pozitën e tyre, interesat, problemet e bashkësisë. Në të njëjtën kohë kur bëhet fjalë për problemet specifike të grave,zëri I këtyre grave rrallë dëgjohet.Ajo do të thotë se ato vuajnë nga një diskriminim I dyfishtë si grup grash dhe si grup krahasuar me burrat brenda bashkësisë së tyre.

102. Prandaj ky paragraf e shtron problemin e nevojës për kyçjen e grave nga minoritetet,dhe ardhacak e në vendosje me qëllim që të bëhet llogari për nevojat e tyre të veçanta, dhe të bëhet krahasim me ato të burrave nga bashkësitë e tyre.Pjesëmarrja e tyre p.sh. në komisione në nivel lokal e nacional mund të jetë e dobishme për shoqërinë në tërësi sepse kontribuon për fuqizimin e koherencës nacionale dhe favorizimin e dialogut dhe inter –religjior.

103. Termi – pakicë etnike, është lënë secili shtet ta përkufizon sepse asnjë konventë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nuk e përkufizon këtë term.Qasja dhe metodat të pranuar për promovimin e grave ardhacake dhe minoriteteve etnike e kulturore shpesh herë janë të ngjashme me masat të cilat shfrytëzohen për promovimin e grave në përgjithësi.Qëllimi është të kyçen grupe të caktuara grash,që do të thotë se metodat që do të shfrytëzohen do të adaptohen për nevojat e tyre.

104. Propozimi I mbulon të gjitha nivelet relevante të vendosjes sipas legjislativës nacionale.

## Paragrafi 27

105. Në disa vende partitë politike kanë menduar strategji të cilat do të ndikojnë në partitë tjera. Qeveritë mund të luajnë rol aktiv në ikurajimin e partive politike për zhvillimin e strategjive ose metodave speciale për ritjen e mundësive të grave që të zgjidhen. Qeveritë mund të asistojnë ose t’I këshillojnë partitë politike për këto çështje.

Maqinaria nacionale për barazi gjinore mund të ketë rol aktiv në implementimin e përmbajtjes së këtij paragrafi. I mundësohet çdo partie politike ta zhvillojë strategjinë e

vet, por është me rëndësi të sigurojnë informata për faktorët nxitës si garancë për një procent minimal I kandidatëve të zgjedhur nga secila gjini, trajnim dhe programe për mentore për gratë për ta rritur numrin e grave brenda në parti, duke pranuar shembuj të cilët të tjerët do t'i ndjekin. Inkurajimi I qeverive mund të jetë në formë financiare p.sh. organizimi I grave në parti politike (shiko shpjegimin në paragrafin 4) ( shih shembullin në Shtesën 7 dhe publikimin „Arritja e barazisë gjinore”).

## Paragrafi 28

106. Pjesëmarrja e grave në vendosje në organizatat e punëdhënësve dhe të punësuarve gjatë kohë ka qenë e vogël bile edhe më e vogël se sa në vendosjen politike. Derisa gratë janë më shumë se gjysma e fuqisë punëtore në shoqërinë e sotme, ato nuk janë në tavolinat negociuese dhe në pozitave vendimmarrëse. Ashtu si partnerët social jo gjithnjë I kushtojnë vëmendje barazisë gjinore ashtu, qeveria ka për qëllim të njëjtat t'i inkurajojë ta bëjnë atë. Kjo mund të realizohet me përkrahje financiare të programeve të grave të inicuar nga sindikatat dhe/ose lidhjes së punëdhënësve. Këto programe do të synojnë kah forcimi I pozitave të grave dhe mundësitë për të fituar pozita vendimmarrëse për promovim më të madh dhe pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në organizatë. Masat e ndryshme të propozuara në paragrafët e lartëshënuara për pjesëmarrje të barabartë mes gjinive në jetën politike e publike mund t'iu n'ihmojnë grave në organizatat dhe punëdhënësve.

## Paragrafi 29

107. Qeveritë kanë obligim ligjor të mundësojnë barazi gjinore në strukturat qeveritare por edhe në shoqëri në tërësi. Në shtetin demokratik ka kufizime masave të cilat qeveria mund t'i miraton, ose obligimet të cilat mund t'ua inponon ndërmarrjeve dhe shoqatave.

Mbështetja financiare ose beneficionet financiare e ndërmarrjeve private të cilat tregojnë interesim për barazi gjinore janë masa të cilat qeveria mund t'i përdorë për sigurimin e kornizës juridike dhe politike në fushën e barazisë gjinore. Në shumë vende, arritja e shumë ndërmarrjeve dhe shoqatave deri te përparësi të caktuara ( masa fiskale , grante publike, marrëveshje me qeverinë ) varen nga pajtimi I tyre me disa obligime të caktuara statutare. Një nga këto obligime mund të jetë aty ku është e mundur pjesëmarrje e barabartë gjinore në organet udhëheqëse.

108. Në disa vende anëtare të Këshillit të Evropës dhe ndërmarrjet private janë të obliguara të sjellin programe për barazi gjinore si pjesë e politikës së tyre lidhur me personelin. Qeveritë duhet të sigurojnë sjelljen e masave efektive për pjesëmarrje të barabartë dhe pozita udhëheqëse në korniza e ndërmarrjes. Kjo veçanërisht është e rëndësishme kur ndërmarrjet ose shoqatat sigurojnë shërbime publike ose implementim të politikës publike.

## Paragrafi 30

109. Ky paragraf përqëndrohet në ngritjen e ndërgjegjes së opinionit në përgjithësi për rëndësinë e pjesëmarrjes së të dy gjinive në vendime. Kryesisht kjo ka të bëjë me vendimmarrëjet politike, por edhe për atë publike në komisionet qeveritare dhe pozitat të cilat I cakton qeveria. Jeta politike akoma është në dominim të burrave dhe burrat janë shumica që I posedon pozitat vendimmarrëse. Shpesh herë gra të përgatitura nuk janë zgjidhur ose nuk janë emëruar në komisione qeveritare për shkak se nuk e kanë besimin e atyreve që janë për seleksionim. Shpesh herë këta selektorë mendojnë se gratë nuk janë edukatë për atë vend. Këtë diskriminim kundër grave shpesh e bëjnë duke u mbështetur në faktin se opinioni nuk ju beson grave aq sa u beson burrave në pozitat të atilla.

110. Shumë faktorë janë themeli I pjesëmarrjes së vogël të grave: historik, kulturor, socio-ekonomik, imixhi I grave në medime, përdorimi I gjuhës seksiste, por edhe faktorë politik si dhe kriteriumet për selektim dhe proceset në partitë politike institucionale të mbështetura në vlerat mashkullore. Ndarja tradicionale e roleve mes grave dhe burrave e përbëjnë pengesën plotësuese siç janë shembujt e përmendur të cilët nuk përputhen me secilin individ por përbëjnë pjesë të organizimit shoqëror.

111. Qëndrimi I opinionit më të gjërë është shumë I rëndësishëm dhe mund të ketë ndikim pozitiv ose negativ për zhvillimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave. Ndikim negativ do të ketë nëse opinioni nuk ju beson grave për vendosje politike dhe publike, nëse direkt ose indirekt përkrahet pasiviteti I qeverisë. Ndikim pozitiv do të ketë nëse opinioni më I gjërë kërkon ndryshime në mënyrë indirekte p. sh. Përmes anketave ose kur drejtpërsëdrejti shprehet rëndësia e ndarjes së fuqisë mes meshkujve dhe femrave.

112. Kampanjat për ngritjen e ndërgjegjjes janë për opinionin më të gjërë me qëllim që të ndryshohen qëndrimet tradicionale dhe diskriminuese ndaj femrës të cilat trguan rezultate të lakmueshme. Këto kampanja mund të koncentrohen në këto veprime sepse qëllimi për pjesëmarrje të barabartë bashkohet me definicionin për demokraci të mirëfilltë ose përqëndrimi në demokraci të mirëfilltë dhe parakushtet për ta arritur atë.

## Paragrafi 31

113. Mënyra se si janë caktuar rolet e meshkujve dhe femrave në shumicën e shoqërive tradicionale I vendosin burrat në pozita udhëheqëse kurse gratë të kujdesen për shtëpinë dhe familjen.



114. Të jesh e kurorëzuar dhe të kesh fëmijë është pengesë për gratë, të cilat në mënyrë aktive duan të marrin pjesë në jetën politike dhe publike. Fakti se shumica e burrave harxhojnë shumë pak kohë lidhur me aktivitetet rreth familjes dhe punët e shtëpisë e bashkuar me qëndrimet tradicionale për ndarjen e roleve, mungesa e infrastrukturës adekuate për përkrahje të familjes dhe pagat e ulta të shumicës së grave mundet negativisht të reflektohet në pjesëmarrjen e saj në politikë.

115. Pjesëmarrja në politikë dhe jetën publike nuk kërkon vetëm logjikë të shëndoshë por edhe klimë dhe përmbajtje psikologjike nga familja, duke l'u mundësuar grave që ta rregullojnë ashtu orarin e tyre të punës që të mos ndihen fajtores se nuk kujdesen për familjen.

116. Shumë vende – anëtare janë duke e kuptuar se harmonizimi i jetës private dhe profesionale është shumë e rëndësishme për arritjen e barazisë mes dy gjinive. Sido që të jetë zmadhimi dhe integrimi i grave në tregun e punës së shtë gjithnjë e lidhur me pjesëmarrjen koresponduese të burrave në punët e familjes dhe përgjegjësitë.

117. Në kundërshtim me atë që rëndom është e pranuar në shoqërinë tonë se sfera publike dhe shtëpiake s'janë të ndara. Ne nuk mund ta injorojmë ntyrën politike dhe rëndësinë e të drejtës në jetë private. Ajo që ndodh në jetën private është e lidhur me politikën, administratën publike dhe shoqëria duhet të intervenon kur funksionimi në sferën private tregon thyerje të të drejtave të njeriut veçanërisht të drejtën në pjesëmarrje. Debati social lidhur me pyetjet rreth barazisë e vë në pyetje ndarjen tradicionale të rolit të femrave dhe meshkujve duke i senzibilizuar burrat për obligimet e tyre në familje dhe dobitë që mund ata t'i kenë për vete, shoqërinë dhe mund të kontribuojnë për krijimin e kushteve më të mira për pjesëmarrjen e grave.

## Paragrafi 32

118. Ky paragraf ka të bëjë me ngritjen e vetëdijes së grupeve specifike për rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të meshkujve dhe femrave përmes kampanjave të orientuara.

Kësisoj kampanja kryesisht duhen të përdoren te politikanë dhe partnerë social si dhe te ata që rekrutojnë kandidatë potencialë dhe që nominojnë vendimmarrës politikë e publikë, vetëdija e lartë te këta persona të cilët e kanë fuqinë për të ndryshuar është me rëndësi jetike. Si paragrafi 30 ashtu edhe ky kryesisht është për ata që vendosin në sferën politike, atë publike dhe për komisionet qeveritare.

119. Paragrafi s'është i kufizuar vetëm në grupet e përmendura. Atje ku ka nevojë duhet të organizohen kampanja për ngritjen e vetëdijes të drejtuar për grupe specifike në nivel kombëtar. Një grup mund ta përfaqësojnë gratë, sidomos në vendet ku tradita si votimi familiar janë evidente ( shih paragrafet 2 dhe 3 si dhe dispozitat e rekomandimit ). Është me rëndësi se gratë e dijnë për faktin se në votat e tyre ka fuqi. Grupi tjetër mund të jenë njerëz të rinj të cilët kanë pak besim në ata që marrin vendime politike.

### Paragrafi 33

120. Qëllimi I këtij paragrafi është të theksohet se ministrat dhe liderrët tjerë të shoqërisë duhet të dijnë se ç'është barazi gjinore dhe të jenë të vetëdijshëm për faktin se gratë dhe burrat kanë jetë të ndryshme deri një gradë prandaj edhe kanë përvoja të ndryshme, nevoja të ndryshme dhe prioritete. Kjo është një argument I rëndësishëm pse ndarja e fuqisë mes meshkujve dhe femrave është parakusht I rëndësishëm për demokraci të mirëfilltë. Organizimi I seminareve interaktivë të cilët do t'I prezantojnë statistikatat mes burrave dhe grave për mejnstrimingun e barazisë gjinore në krijimin politik të vendimeve të qeverisë.

Prezentimi I obligimeve të qeverisë dhe politikës qeveritare në këtë sferë janë kryesore. Shembuj për iniciativa të këtilla mund të gjenden në „ Ecja kah barazia gjinore ”.

### Paragrafi 34

121. Ky paragraf ju rekomandon qeverive që t'I përkrahin OJQ, institutet hulumtuese në mënyrë financiare etjera në hulumtimin e pjesëmarrjes së femrave në procesin e vendosjes, këti lloj hulumtime do të siguronin bazë avancimin e vendosjes së qëllimeve, në të njëjtën kohë mund të bëhet evaluimi I prezencës ose jo prezencës së femrave.

122. Një pyetje që shpesh herë shtrohet është - a bën ndonjë dallim pjesëmarrja e grave në vendosjen politike e publike. Pjesëmarrja e barabartë në këto sfera s'ka nevojë të arsyetohet. Edhe hulumtimet vërtetojnë se pjesëmarrja më e madhe e grave sjell ide të ndryshme, interesa dhe perspektivë në vendosje dhe mjedisi I vendosjes. S'mund të pritët që qeveritë të bëjnë kësioj hulumtimi por munden që t'I përkrahin institutet përkatëse.

### Paragrafi 35 – 38

123. Hulumtimi I pengesave që e pengojnë hyrjen e grave në vendimmarrje politike e publike në të njëjtën kohë është kuptimi I problemeve dhe krijimi I kushteve për përdorimin e masave. Qeveritë duhet të promovojnë hulumtime në këto dy sfera, edhe pse këto lëmi janë mjaft të ndryshme,por edhe pengesat në të cilat hasin gratë janë të ndryshme.

124. Hulumtimi me anë të anketave për trendet votuese për gratë dhe burrat mund ta theksojnë ndikimin e votuesve me votat e tyre për partitë politike, kësioj hulumtimi duhet të vërteton se –a ekziston zbrasti gjinore në preferencat e votuesve dhe partisë.

Nëse ka jobarazi është interesant se pse është kështu. Ky hulumti mund ta tërheqë vëmendjen e partive politike për prioritetet që kanë për aplikimin e barazive. Këto hulumtime duhet të përkrahen financiarisht për t'i kuptuar pyetjet, interesat, pjesëmarrjen, përfaqësimin etj.

125. Pjesëmarrja e barabartë e grave dhe burrave në vendosje kërkon kuptim të rrethanave – individuale, kontekstuale, kjo e inhibon pjesëmarrjen e plotë të grave në arenën politike e publike. Kuptimi i këtyre barrierave ju mundëson pjesëmarrje të barabartë grave në pushtetet më burrat. Shpallja e rezultateve të këtyre hulumtimeve ju ndihmon OJQ, partive politike dhe grupeve tjera relevante të zhvillojnë strategji qëllimore të cilat dizajnohen për ta tejkaluar pabarazinë mes grave dhe burrave në vendosje.

126. Gratë veçanërisht janë aktive në sektorin social dhe humanitar. Shpesh pjesëmarrja në aktivitete shoqërore është hapi i parë, për shumë gra në jetën politike. Në shumë instanca sektori social e humanitar janë ekonomi me pavarësi. Financimi substancial mund të hyjë në këtë sektor nga burime të ndryshme private. Sektori mundëson mundësi të mira për punësim dhe të ketë strukturë drejtuese fragmentare ose të vetme.

Edhe përkundër obligimeve dhe punëve që bën gruaja, shumë pak është e prezentuar në organizatat volonter, në eshalonet për punë sociale etj. Rritja e rëndësisë së sektorit vullnetar deh social si partner i tretë në trijadën politikë – ekonomi – dhe socialë si vendimmarrëse është me rëndësi të hulumtohet pjesëmarrjen e grave, pengesat e tyre për pozita vendosëse.

127. Hulumtimi momental për stilet e dhëheqjes së grave dhe burrave ligjdhënës tregon se ka ndryshime në stilin e tyre negocues, prioritetet për politikë dhe mënyrat e punës në kornizat e Parlamentit. Hulumtime tjera tregojnë se organet ligjdhënëse të cilat normave mashkullore ju japin pozitë më dominante janë më të rënda për gratë. Nëse gratë ikurajuar për të marrë pjesë në kuvendet është e rëndësishme të zhvillohet organi i cili do t'i hulumton dallimet në peripetitë, sjelljen, ambiciet, prioritetet e grave dhe burrave përfaqësues, në drejtim të zhvillimit si punën legjislative, ç'është bërë që këto obligime të jenë atraktive siç janë për burrat.

#### Paragrafi 39 –41

128. Mendimet kanë rrol të rëndësishëm në demokratizimin e shoqërisë, kurse pavarësia e medimeve është krucijale, gazetarët dhe profesionistët tjerë nga medimet duhet të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësinë e tyre kur bëhet fjalë për prezantim objektiv e jo imixh stereotip për gratë dhe burrat.

129. Paragrafi 39 është nxjerru nga Platforma e Pekinit për veprim. Numri i gazetarëve – femra në kohën e fundit, 10 vitet e fundit, dukshëm është zmadhuar por ato

ende janë të marxhinalizuara në organet e përmendura të paragrafit dhe s'kanë ndonjë dikim në politikën e medimeve.

130. Nga konferenca e 4 botërore e grave shumë pak është bërë pa imixhin e grave në medime, nga qeveritë dhe medimet. Në prill të v. 2002 Kuvendi parlamentar I Këshillit të Evropës ka sjellur rekomandim për imixhin e grave në medimet, duke I ftuar qeveritë për sjelljen dhe implementimin e politikës kundër imixheve stereotipe seksore dhe të ketë më shumë organe që do ta mbikqyrin këtë situatë.

131. Kampanjat të cilat u organizuan në disa vende për t'I bindur gazetarët dhe redaktorët se prezentimet e tyre për barazi gjinore s'është gjithmonë neutrale ( shih publikimin „ Ecja kah barazia gjinore ” ). Gazetarët duhet trajnuar për pyetje gjinore me qëllim që të promovojnë imixh të njëjtë në medime si për gratë ashtu edhe për burrat.

132. Paragrafi 41 merret me pyetjet e sigurimit të paraqitjes së barabartë të burrave dhe grave kandidatë në medime. Gjatë kohës së kampanjave zgjedhore, temat me të cilat merren medimet dhe koha e cila u ndahet grave dhe burrave mund të ketë ndikim në rezultatet zgjedhore. Në Zvicër është bërë një studim lidhur me këtë problematikë në zgjedhjet federale 1999. Qeveritë duhet t'I përkrahin iniciativat për analizën e procedurave zgjedhor nga aspekti gjinor.

#### D. Vëzhgimi

##### Paragrafi 42 dhe 43

133. Qëllimi kryesor I këtyre paragrafëve është që të tërhiqet vëmendja e qeverive për faktin se baza e gjithë kësaj pune pëe avancimin e barazisë me kohë është bërë përparim. Në bazë të këtyre njohurive dhe evaulimit qeveria do të vendosë qëllime të reja dhe do të inicon programe. Paragrafi 42 e tërhjek vëmendjen për kërkesën e një organi të pavarur, përgjigjës për politikën qeveritare në fushën e barazisë. Ky organ mund të jetë mediator, vëzhgues ose departament special në maqinerinë nacionale për barazi. Shembull për kësioj vëzhgimi e opservimi për paritet në Francë. Duhet të ceket se observatoriumet për paritet ose agjencitë mediatore të kësaj natyre s'kanë fuqi, nëse nuk ju mundësohet të kenë mjete financiare.

134. Me qëllim që të jetë I aftë për të vëzhguar përparimin, janë të nevojshme shënime komparative segreguese. Për këtë qeveritë duhen të venë dhe aplikojnë indikatorë për vëzhgim dhe evaluim për përparim në fushën e barazisë në vendosje dhe jetën politike e publike. Në paragrafi 44 janë dhënë shembuj dhe indikatorë. Aplikimi I tyre do të sigurojë raport I cili do të jetë I krahasuar ndërkombëtarisht.

##### Paragrafi 44

135. Indikatorët e propozuar nga ky paragraf japin pamje për diametrin e arenës vendimmarrëse në politikë. Këta indikatorë janë propozuar ashtu që qeveritë mund t'i kompilojnë shënime për përbërjen vendimmarrësit politik e publik, I përcjellin ndryshimet me kohë dhe I mundësojnë analizë të profitit të vendosësne në cilin do vend dhe bëjnë komparacione ndërnacionale.

136. Numri I grave dhe burrave të zgjedhur sipas partive politike është indikator për progresin e realizuar nga partitë që ka të bëjnë me pjesëmarrjen e grave në parlament. Numri I përfaqësuesve në parlamentet dhe sub – parlamentet mund të llogariten. Indikatorët në nivel federal dhe regional fuk të llogariten mund të krahasohen me ato në nivel nacional dhe sub – nacional.

137. Shkalla e suksesit mundëson lidhje mes grave dhe burrave përfaqësues dhe kandidatë. Kjo shkallë I tregon mundësitë për zgjedhje të kandidatit. Shkalla e suksesit shpreh lidhjen mes përqindjes së përfaqësuesve të zgjedhur dhe përqindjen e kandidatëve.

Kjo llogaritet në këtë mënyrë:

Shkalla e suksesit të femrave = përqindja e grave përfaqësuese të zgjedhura.

Përqindja e grave kandidate X 100.

Shkalla e suksesit të burrave = përqindja e meshkujve të zgjedhur.

Përqindja e meshkujve kandidate X 100.

138. Nëse përqindja e grave përfaqësuese dhe kandidatë është I barabartë ( p.sh. 30 % të zgjedhur 30 % kandidatë ) shkalla e suksesit është 100. Shkalla e suksesit më tepër se 100 tregon se përqindja e kandidatëve të zgjedhur është mbi mesatare, kurse nën 100 tregon numra mesatar. Duhet theksuar se shkalla e suksesit është sukses me vlerë relative, andaj mund të sigurohen vetëm informata provuese për shancat e vërteta të kandidatëve të cilët do të zgjedhen.

#### Paragrafi 45

139. Indikatorët e prezantuar në paragrafin 44 ofrojnë strukturë kuantitative për strukturën e grave për raportet parlamentare për pjesëmarrjen e meshkujve dhe femrave në vendimet politike dhe publike. Si indikator ata mund të ndihmojnë për grumbullim sistematik të shënimeve, gjatë kohës kjo do të ju ndihmon qeverive dhe parlamentit ta mbikqyrin, diskutojnë dhe të marrin akcion për pjesëmarrje të njëjtë të të dy gjinive në vendosje. Këto statistika janë jetike për komentet informative lidhur me këtë dhe mund të jenë pikënisje për hulumtim kualitativ për jobarazinë e pjesëmarrjes së grave dhe burrave në vendosje kualitative dhe kuantitative mund t'ë kontribuojnë në implementimin e strategjive të provuara të dizajnuara për t'i anuluar jobarazitë.

140. Element I rëndësishëm në këtë proces është paraqitja e raporteve në tabela për pozitat e të dy gjinive në vendosje dhe për arritjet. Pranimi I raporteve nga

ligjëdhënësit e reflekton rëndësinë e pyetjes dhe gëpatat parlamentare në këtë temë, duke e theksuar efektin ( dhe anasjelltas ) për masat specifike. Diseminimi I gjërë I këtyre raporteve siguron një pasqyrë të tërësishme të grave dhe burrave në procesin e vendosjes në shoqëri.

141. Raporte të këtilla, pa marrë parasysh evaulimin dhe funksioni I vëzhgimit do të ndihmojë për hapjen e një diskutimi në shoqëri duke e kyçur edhe parlamentin, për pyetje lidhur me barazinë dhe përparimi I arritur. Kjo do të mundëson aplikimin e masave dhe do të bën shtypje në partitë politike, institucionet qeveritare dhe institucione tjera ku ka përparim të vogël dhe të tjerët do të inkurajohen. Në shumë vende anëtare të Këshillit të Evropës, qeveritë kanë obligim juridik t’I lajmërojnë rregullat p.sh. parlamentet nacionale dhe organizatat ndërkombëtare si UE dhe komitetin SEDAV. Përparimi i arritur në këtë fushë dhe evaulimi I masave të aplikuara të kyçet në këto raporte. Raportet gjinore të mbështetura mbi këtë rekomandim s’duhet të kuptojnë punë plotësuese. Rportet të cilët disiminohen më gjërë duhet të jenë të dobishëm në mënyra tjera. P.sh. informatat e siguruar mund të shërbejnë si themel për raportet e prezantuara nga Komitetet udhëheqësve për barazui pranë Këshillin e Evropës dhe komiteti I ministrave.

#### Paragrafi 46

142. Ky propozim ngusht është I lidhur me paragrafin 45 dhe do të jenë raportet e njëjta. Dallimi kryesor është se paragrafi 45 është përqendruar në informimin e parlamenteve nacionale për të arriturat kurse ky paragraf ka të bën për informimin e opinionit më të gjërë.

#### Paragrafi 47

143. Si plotësim I statistikave të dhëna në paragrafin 44,statistikat e këtij paragrafi japin analizë kualitative të informatave për kandidatët e zgjedhur.A ekzistojnë dallime mes meshkujve dhe femrave mes dy gjinive në moshë profesion,përgatitje,trajnim? Analizat e këtilla mund t’I prezentojnë mënyrat e ndryshme me të cilat kandidatët janë zgjedhur dhe çfarë ndikimi kanë moshë,profesioni dhe trajnimet në mundësinë për t’u zgjedhur. Këto analiza mund të japin përgjigje edhe për pyetje tjera p.sh.gratë e zgjedhura a janë më të moshuara se burrat (a mund të vërehet dallim në ndërtimin e karrierës?).

#### Paragrafi 48

144.Siç është cekur në paragraf. 30 dhe 41 imixhi I grave në medime akoma ngel negativ dhe vazhdon të jetë stereotip dhe seksor. Derisa bota bashkëkohore ka pasur ndryshime rapide,imixhi I grave në medime pothuajse ka ngelur I njëjtë.

145.Kur shikohet mënyra se si femrat dhe meshkujtjanë të profiluar në Tv, hulumtimet kanë treguar se femrat janë më pak prezente.Kjo tregon se ka mundësi më të vogla për ta njohur dhe të krijimit të identitetit.Burrat shpesh herë në rolin e ekspertëve,politikaneve ose shkencëtarëve kurse femrat shihen si viktime të dhunës ,nëna,shtëpiake.

## Shtesa 1

### Qëllime të lidhura me kohën

Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar beson se femrat dhe meshkujt duhet të kenë barazi në të gjitha emërimet.Qëllimi është të ketë 45-50% gra në emërimet publike në shumicën e departamenteve qeveritare deri në fund të v.2005 „Organe publike e publikuar më 14.2.2002 tregon se më 31 mars 2001 gratë kanë qenë të emëruara 34% në këshillat e ndryshëm,organe shëndetësore,korporata etj.

Me qëllim që të përmirësohet niveli I përfaqësimit qeveria një herë në vit paraqet raport „Organet publike:emërimet”i cili I vendos qëllimet të cilat departamentet qeveritare në mënyrë individuale do të bëjnë zmadhimin e numrit të emëruarve në fafor të grave në planet e tyre të veprimit.

## Shtesa 2

### Barazia gjinore në emërimet publike

Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar I është kushtuar her përfaqësimit të grave në jetën publike.Hulumtimi I bërë nga qeveria e MB,dallimet gratë dhe emërimet publike( DTLR dhjetor 2001 ) ka zbuluar se pengesat kryesore për gratë që të marrin pozita publike janë:mungesa e vetëdijes për mundësitë,pëlqimi I pozitës dhe besimi I obligimit që kërkohet.

Gratë e Departamentit për barazi të udhëhequra nga ministri për pyetje femërore,kanë mbajtur seminare nëpër mbarë vendin,me qëllim që të punojnë lidhur me pengesat e cekura. Grupi qëllimor I seminareve ishin gra me një përvojë relevante në nivel lokal (magjistraturë drejtorë shkollash)dhe I kanë inkurajuar të paraqiten për emërimet në nivel nacional.Seminaret janë organizuar për gratë të inspirohen nga CASE STUDIES dhe idolët.Seminaret kanë siguruar informata praktike për atë që të paraqiten,kurse për gratë e pakicave etnike janë organizuar seminare enkas e poashtu edhe për gratë nga sindikati dhe biznismenët.

Kundrejt kësaj pune Komisioni nacional I grave kanë vendosur rrjetë elektronike të grave pjesëmarrëse dhe kjo ka mundësuar komunikim me mentoren dhe përkrahje, informata dhe ndihmesë.

Gratë e Departamentit për barazi kanë bërë hulumtim lidhur me këtë veprim me qëllim që kjo mënyrë e punës të jetë model për punë dhe të promovohet në praktikë dhe eksperiencia e femrave për emërimet publike të mund të inkorporohen në krijimin e politikës.

### Shtesa 3

Ndryshime kushtetuese dhe ligjore për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë

#### Belgjikë

Nga frori I v. 2000 Kushtetuta e Belgjikës në mënyrë eksplicite e stimulon parimin e barazisë mes dy gjinive. Neni 10 I Kushtetutës tani është: „ Barazia mes meshkujve dhe femrave është e garantuar ”, edhe Neni 11 b. thotë: „ ligji, dekreti ose rregulla e dhënë në Nenin 134 ju garanton femrave dhe meshkujve të disponojnë në mënyrë të barabarta me të drejtat dhe liritë e tyre, dhe në mënyrë transparente e promovon qasjen e tyre në pozicione të barabarta”.

Një dispozitë shtuese gjithashtu deklaron se uniseks qeveritë janë jokushtetuese në të gjitha nivelet e miratimit të vendimeve.

Amandamenti kushtetues kontribuoi miratimin e disa akteve të cilat do ta mbështesin dispozitën e paraparë me aktin e 24. V. 1994 I cili ka të bën me promovimin e barazisë mes kandidatëve në listat zgjedhore. Sipas këtij akti numri I kandidatëve nga gjinia e njëjtë s'mund t'i kalojë 2 /3 nga numri I përgjithshëm I vendeve që duhet të plotësohen. Aktet e reja ( të miratuara 17.6 dhe 18.7 2002 ) arrijnë paritet gjinor dhe përfaqësim në listat të kandidatëve për zgjedje regjionale në Evropë.

#### Franca

Ligji kushtetues I 8.7 1999 vendosë parimin e barazisë në vendet zgjedhore dhe pozita. Neni 3 I kushtetutës thirret në ligjin dhe përgjegjësitë duke promovur të njëjtat.

Reforma u shndërrua në ligj më 6.6.200me të cilin listat zgjedhore dallimi mes kandidatëve meshkuj dhe femra s'mund të jetë më shumë se një. Për zgjedhje që kanë vetëm një rreth të dy gjinitë duhet të jenë të prezentuara në mënyrë alternative kurse në ato me dy rrethe (zgjedhje komunale,regjionale etj.)secila gjini duhet të prezentohet me numër të barabartë. Në zgjedhjet parlamentare do të ketë dënime me të holla për partitë që s'do të kandidojnë 50% gra. Nëse dallimi mes kandidatëve nga secila gjini kalon 2% ,partia do të dënohet. Finansimi që bëhet në bazë të votave të fituara nga rrethi I parë (rreth 11 centimë për votë ) do të zvogëlohet procentalisht baraz me gjysmën mes grave dhe burrave dhe burrat -kandidatë e shprehur si përqindje nga numri I përgjithshëm I kandidatëve.

Zgjedhjet komunale të 11 dhe 18 mars 2001 të cilat ishin testi I parë për ligjin treguan se kjo është mënyrë efektive për promovim të borgjezisë.Më se 38.000 gra fituan vende në komitetet komunale dhe qyteteve me më tepër se 3500 banorë që është 47.5% nga përfaqësuesit e zgjedhur.Ajo ishte hap I rëndësishëm,pothuajse u dyfishua numri I përfaqësuesve.Në anën tjetër rrezultatet nga zgjedhjet parlamentare në qershor 2002 nuk dhanë rrezultat të ngajshme.Vetëm 71 gra u zgjodhën nga 577 anëtarë të parlamentit (12.3%).

Kjo ishte një rritje krahasuar me numrin e 1997 prej 10.9%.Gratë përfaqësonin 38% ngakandidatët 22% në 1997dhe vetëm një e katërta nga ato ishin të zgjedhura.

#### Italia



Dy ligje zgjedhore u miratuan më 1993. Në Akt No 81 nga 25.3.1993 paragrafi 2 nga Neni 5 paragrafi 1 nga Neni 7 votojnë në listat e kandidatëve s'mund të përmban më tepër se 2/3 e cilës do gjini. Akt No 27 gusht 1993 vendosi rregulla për zgjedhje të Domësë së zëvendësve. Ky ligj, obligon që prej tani Dhoma e zëvendësve prej tani do të aplikon sistem të përzier 75 % kandidatë të zgjedhen mbi bazë të shumicës kurse 25 % do të zgjedhen sipas sistemit sipas listave. Për këtë kategori paragrafi 2 nga Neni 4 thotë se burrat dhe gratë duhet të përfaqësohen me nga 50 % në lista. Këto ligje u anuluan nga Gjyqji kushtetues I Italisë në bazë të asaj se e drejta fundamentale e njeriut, si dhe e drejta për të marrë pjesë në zgjedhje, s'mund të jetë subjekt I cili trajtohet në bazë të gjinisë.

#### Maqedonia

Në maj të v. 2002, Ligji për zgjedhje të deputetëve në parlament u miratua Neni 37 I cili thotë se secila listë e kandidatëve duhet të përmban së paku 30 % nga të dy gjinitë. Në shtator 2002 në zgjedhje 18.3 % gra u zgjedhën në krahasim me 7.5 % të v. 1998.

#### Mbretëria e Bashkuar

Në shkurt 2002 qeveria prezantoi legjislativë që t'iu prezanton partive politike të ndërmarrin masa pozitive për zvogëlimin e jobarazisë gjinore, në zgjedhjet lokale, nacionale dhe evropiane. Akti është pozitiv dhe ju mundëson partive politike nëse duan të ndërmarrin masa pozitive.

Akti ka klauzolën „ perëndimi I diellit ” I cili mund të shkakton që dispozitave t'iu kalojë afati deri në fund të vitit 2015. Kjo do të mundëson së paku tri zgjedhje të realizohen sa I përket legjislativës. Klauzola poashtu lejon që dispozitat të Aktit të vazhdojnë si legjislativë sekondare nëse ka ashtu rasti në 2015.

#### Shtesa 4

#### Përfaqësim I barazisë gjinore në komitetet publike

#### Danimarka

Në Danimarkë, Akti I komitetit ka qenë I aprovuar 1985 kurse Akti I bordit 1990. Në të dy rastet ishte theksuar se barazia gjinore duhet të adoptohet. Qeveriaria e fyer, organizatat dhe organet ishin të ngarkuar të propozojnë numër të barabartë të meshkujve dhe femrave kur emërojnë anëtarë të komisioneve. Akti I ri danez për barazi gjinore I cili u miratua në v. 2000 thotë se të gjitha komisionet dhe bordet të emëruara nga ministri me detyrë të përgatisin rregullativë ligjore për çfarë do lloj ose me detyrë për krijimin e politikës se medoemos duhet të ketë përfaqësim të barabartë të të dy gjinive.

Të gjitha organet publike të cilat kandidojnë anëtarë për komitet ose këshillë duhet të kandidojnë mashkull ose femër, në rast kur duhet të emërohen më shumë se një person.

## Finlanda

Akti për barazi mes grave dhe burrave në Finlandë ( 8.8 1986 / 609 ) Seksioni 4: „Pushteti do të promovon barazi mes grave dhe burrave me destinim dhe sistematikisht, veçanërisht me ndërimin e rrethanave të cilat e pengojnë realizimin e barazisë.

Përçinjsda minimale e grave dhe burrave në komitetet qeveritare dhe këshillat këshilldhënëse dhe organe tjera korresponduese dhe në organet e komunës, do të jetë 40, në rast se nuk ka shkaqe të veçanta për të kundërtën. Nëse një agjencion, institucion, komunë ose ndërmarrje në pronësi shtetërore ka këshill administrativ, ndonjë organ tjetër ekzekutiv I cili përbëhet nga përfaqësues të zgjedhur apo të emëruar duhet pasur kujdes për përfaqësim të barabartë të të dy gjinive nëse s'ka shkaqe të veçanta për atë.

## Norvegjia

Neni 21 I Aktit norvegjes për barazi gjinore thotë: „ Secila gjini do të përfaqësohet më së paku me 40 % nga anëtarët kur organi publik do të zgjedhë ose emëron komisione, organe drejtuese etj. Me katër anëtarë ose më shumë. Të dy gjinitë do të përfaqësohen në komisione me dy ose tre anëtarë. Këto dispozita poashtu ju dedikohen edhe anëtarëve ndihmës.

„Përjashtime nga paragrafi I parë mund të lejohen nëse rrethanat e veçanta e bëjnë të pa kuptueshme kërkesën që të lejohen”.

„Komisionet etj. Të cilat sipas të drejtës statutare përbëhen vetëm nga anëtarë nga organe të zgjrdhura direkt nuk duhet t’I plotësojnë të drejtat e këtij Neni.

## Shtesa 5

Komitetet parlamentare ose delegacionet për të drejtat e grave dhe mundësi të njëjta

## Franca

Delegacionet parlamentare për të drejtat e femrave dhe barazi profesionale janë themeluar në Francë. Delegacioni I Kuvendit nacional ka qenë I arritur me ligj 12.7.1999.

Këto delegacione janë të përbërë nga 36 anëtarë. Në fund të v. 2002 anëtarët e saj u emëruan në grupet parlamentare për përfaqësim të barabartë të burrave dhe grave në komisione. Shënimet me përfaqësimin e gjinive në mënyrë të barabartë mund të dërgohen përmes Birosë së kuvendit, komision permanent ose specil, në atë rast ajo prodhon raport duke kyçur edhe rekomandime. Njëra nga detyrat e saj të para ishte të jep mendim per projekt – ligjin për të lejuar ofrim të njëjtë si për burrat ashtu edhe për gratë e zgjedhura dhe në pozita e kancelari.

## Mbretëria e Bashkuar

## Niveli regjional

Kuvendi I Vellsit ka komision për mundësi të njëjta të cilat e promovojnë parimin për barazi të mundësive të meshkujve dhe femrave përmes funksioneve, këtu mund të kyçet edhe revizioni vjetor I anëtarëve në komision. Prlamenti I Skotlandës ka Komision për mundësi të barabarta. Puna e komisionit është t’I merr parasysht dhe t’I lajmëron për punët lidhur me mundësitë e njëjta në kornizat e Parlamentit Skoces. Komisioni ka marrë parasysht vlerat më të arritura në aspektin e barazisë gjinore ( 26.03.02 ).

#### Niveli lokal

Qeveritë lokale në Angli në moment janë duke I miratuar „ Standardet për barazi ” e cila mundëson që qeveritë lokale të kenë kujdes për obligimet ligjore që janë në ligjin antidiskriminues duke e ndaluar atë në punësim dhe shërbime tjera.

Asociacioni I qeverisë lokale ka zhvilluar Strategji për barazi gjinore ky dokument ka për qëllim të vendosë barazi duke I përgatitur gratë dhe burrat të participojnë barazi në nivel të njëjtë në sferën sociale, politike dhe ekonomike.

Këshilli I Bristollit ka një drejtor për të drejta sociale dhe zhvillim. Ky person është përgjegjës për zhvillimin e politikës për gratë dhe barazi në Këshill.Ka themeluar Forumin e gruas dhe një grupë konsultative për të gjitha pyetjet në Këshill.

#### Shtesa 6

##### Banka për femra – talente

Kvinebasen është themeluar më 1999 dhe udhëhiqet nga Likestillingenteret ( qendër norvegjeze për barazi gjinore ). Qëllimi I kësaj banke për femra – talente është që të prezenton aftësinë e femrave.

Qëllimet kryesore të Kvinebasen janë:

- Zgjedhja e grave në pozita udhëheqëse
- Zgjedhja e grave në pozita në këshilla

Si shtesë baza mund t’I shfrytëzon mediumet për deklarata, intervista dhe nga organiza tjera, poashtu ka për qëllim të shtohet numri I grave në pozita të larta në sektorin privat e publik.

Sot 3.500 gra e kanë paraqitur CV – inë e vet në bazën e shënimeve, 76 % nga ato kanë përvojë me menaxhim 57 % kanë përvojë me punët në këshill. Përgjithësisht gratë në listat e Kvinbase kanë përgaditje shkollorë superiore dhe përvojë në shumë sfera. Ka dallim të madh, mes grave në këto lista, në moshë, përgaditje shkollore, përvojë, trajnimet.

Këto lista janë të hapura mund të shikohen në veb-sajt dhe të merren informata.Të gjitha kandidatet në Kvinbasen marrin biletin mujor për të parë shih.ëëë.kvinnebasen.no

#### Shtesa 7

##### Partitë politike dhe promovimi I pjesëmarrjes së barabartë

##### Mbretëria e Bashkuar

Akti për diskriminim seksual gjatë zgjedhjes së kandidatëve 2002I cili tani është ligj pozitiv I cili u lejon partive politike t'I shfrytëzojnë të gjitha listat e shkurtëra të grave në zgjedhje ( evropiane ,skocese, të vellsit dhe GLA ).

Liberal – demokratët e kanë shfrytëzuar zipes- sistemin në zgjedhjet evropiane 1999 dhe tvingim në zgjedhjet GLA.

Partia laluriste I shfrytëzoi listat e shkurtëra në zgjedjet 1997 ( I cili u kundërshtua me akti për diskriminim seksual dhe e shpalli të pa vlevshëm dhe joligjor – nga këtu ndryshimet e ligjit 2002 ).

Të gjitha partitë përgatisin përgjigje të këtia akti dhe ai do të prezentohet në kuptim që secila parti si mendon ta shfrytëzojë legjislativën pas konferencave në 2002. ( Partia laburiste si duket do t'I heqë këto lista gjer në një nivel liberal demokratët votuan për propozim në konferencën më 2001 për heqjen e listave të shkurtëra dhe vendosën të investojnë në ngritjen e vetëdijes dhe trajnim – andaj është e paqartë se si do të sillen në konferencë 2002. Partia konzervative ka dhënë sinjale për fer lista të kandidatëve.

<http://ëëë.coe.int/equality>

Departamenti për barazi të Këshillit të Evropës

<http://assembly.coe.int/>

Kuvendi parlamentar I Këshillit të Evropës

<http://ëëë.coe.fr/cplre/indexe.htm>

Kongresi për qeveri lokale dhe regjionale në Evropë në K.E.

[http://europa.eu.int/comm/employment\\_social/equ\\_opp/index\\_en.htm](http://europa.eu.int/comm/employment_social/equ_opp/index_en.htm)

Barazia gjinore – EU

<http://ëëë.db/decision.de>

Barazia evropiane e të dhënave –gratë në vendimmarrje

<http://ëëë.ccre.org/site.html>

Rrjeti evropian I grave përfaqësuese të zgjedhura në qeveritë lokale dhe regjionale

<http://ëëë.ëomenlobby.org/index2.htm>

Lobi evropian I grave

[http://ëëë.europarl.eu.int/committees/femm\\_home.htm](http://ëëë.europarl.eu.int/committees/femm_home.htm)

Komiteti I Parlamentit evropian për të drejtat e grave dhe mundësi të njëjta

<http://ëëë.ipu.org/>

Unioni interparlamentar

<http://ëëë.un.org/ëomenëach/daë>

Departamenti I OKB-së për fuqizim të grave

Shënime përfundimtare:

Për më shumë informata për datat në lidhje me të drejtat e grave për të votuar shikoni veb – sajtin Unioni interparlamentar [ëëë.ipn.org](http://ëëë.ipn.org).

Shih shem. „ Gratë dhe politika 1945 – 2000”. „Raporte dhe dokumente” No 37 „ Gratë dhe politika në vendet anëtare të K. E.”

Belgjika,Luksemburgu, Spanja, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore tregun rezervë ndaj Nenit 7 në lidhje me trashëgimin e kurorës kurse Gjermania dhe Zvicra në lidhje me legjislativën e cila I ndalon gratë të kryejnë punë për kohë të konflikteve të armatosura. „ Kongresi dhe qeveritë lokale të Evropës, miratuan

rekomandim në këtë temë 2002, Rekomandimi 111, shih dokumentin CG (9 ) 7 I prezentuar nga Dajen banijan – raportuese.

Duhet kontrolluar legjislativën për këto gjëra: sistemet zgjedhore, shërbimet qytetare, të drejtat e punës ( pushimi mjekësor për fëmijë të lindur ) barazi gjinore ( masa pozitive ). Duhet kontrolluar metodat e partive politike, afrimi I pozitive të zbrasta, procedura nominime.

Raporti përfundimtar për aktivitetet e Grupit të specialistëve KE për veprim pozitiv në fushën e barazisë gjinore EG-S –PA ( 2000 ) 7.

„Ecja kah barazia gjinore ”botim KE 2002 ISBN 92 – 972 – 4901 – 1.

„Gratë në politikë në vendet – anëtare KE

<http://coe.int/equality>

Kjo rezolutë ka të bën me raportin e komisionit të Evropës për implementimin e rekomandimit të këshillit.

IDEA dhe shtesa 88, doracaku për vlerësim të demokracisë, Stokholm: IDEA, 2002

Më 18.11.1982 Këshilli kushtetues ka hequr Nen nga ligji komunal nga 1982 I cili siguronte kuotë 25 % përfaqësim nga secila gjini maks. ( 75 % përfaqësues nga secila gjini ) në listat e kandidatëve në zgjedhjet komunale. Ky vendim ishte I arsyeshëm në emër të barazisë qytetare para ligjit I garantuar me Nenin 3 nga Kushtetuta 1958 dhe Neni 6 nga Deklarata për të drejtat qytetare 1789.

Për informata tjra shih raportin e paraqitur nga parlamenti I Evropës më 1997: Ndikim diferencial në sistemet zgjedhore për përfaqësim të grave në politikë. Serila për të drejtat e gruas EG – S – PA ( 2000 ) 7.

Sindikata ka paraqitur pohim në llogari të grave punëtore të cilat kanë fituar 7 % më pak nga grupi I njëjtë burra – punëtore.

Edhe pse të dy grupet kanë fituar me orë njësoj punëdhënësi ka shtur një shumë të caktuar në shumën bazë sipas kriterëve të ndryshme kështu që sindikata ka treguar se ka bërë diskriminim indirekt ndaj punëtorëve femra.Pasi ESP ka konstatuar strukturë jotransparente rrogash dhe statistikave kanë zbuluar dallim mes rrogës femërore dhe mashkullore, barra e fakteve ka qenë mbi punëdhënësin për dallimin e rrogave që s’janë të lidhura me gjininë.

Marrëveshja kolektive Daneze për punëtore ka vërtetuar orën e punës për punëtore,por lejon zmadhime individuale në bazë të fleksibilitetit që do të vërtetohet në bazë të kualitetit në punë iniciativat e punëtorit etj.Si do që të jetë të punësuarit s’kishin njohuri për kriteret që ishin për ata për ta krahasuar rrogën e tyre me të tjerëve.Meshkujt merrnin pothuajse 7% më shumë rrogë se femrat.

ESF e përshkroi sistemin e rrogave si karakteristike “mungesë totale e transparencës”.Ata përfunduan se Neni 141 ku punëdhënësi e aplikon sistemin e rrogave I cili funksionon paqartë dhe ku do të konstatohet se rroga mesatare e femrës –punëtore është më e vogël se e kolegëve meshkuj,punëdhënësi ka për obligim të tregon se sistemi pagesor s’është I diskriminuar.

ESP ka konstatuar nëse kriteriumi „kualitet I punës”rrezulton me tretman jo fer për gratë punëtore vetëm nëse punëdhënësi ka vendosur ashtu dhe e ka ndërruar kriteriumin ajo do të llogaritet si diskriminim.ESP ka komentuar se është e papranueshme që puna e kryer nga punëtorët të jenë me kualitet më të dobët se sa punëtorët.Andaj

punëdhënësi s'mund ta arsyeton aplikimin e kriteriumit atje ku ai s'është fer ndaj femrave."Enderbi kundër institucionit shëndetësor Frençaj C-127-92,27.10/993 ECR 1-5535,5573.ESP ka gjykuar se aty ku "statistikat kanë pohuar se ekziston dallim në rrogë midis dy punëve me vlera të njëjtë,nga të cilat kryhet vetëm nga femrat kurse tjetra nga meshkujt" atje sigurisht ekziston diskriminim.Atje ku do të konstatohet se punëdhënësi ka përgjegjësi duhet ta shpjegon dallimin në rrogë lidhur me faktorin gjini.Negociatat e mëhershme kolektive s'mund t'i arsyetojnë dallimet në punësimet segreguese.

Rasti ka të bën me dy kolektive të ndryshme terapeutë dhe psikologë në klinikë ku puna me vlerë të barabartë ka renumerim.

Punëdhënësi ka pohuar se gratë janë në numër më të madh në vende të cilat më pak paguhen andaj kjo s'është fakt diskriminues sepse nuk ekzistojnë pengesa që në ato ose profesione tjera të medicinës,dallimi në rroga rezultojnë marrëveshja kolektive të nënshkruara nga ky punëdhënësi dhe sindikatat.Gjyqi I hodhi këto argumente dhe tha se mjafton të vërtetohet dallim në paga,me të cilën gratë kufizohen më shumë se burrat.Kjo duket shumë drejtë sepse në këtë rast diskriminimi I institucionalizuar për të treguar se ekziston pengesë ka bërë të pamundshme ta zhdukë diskriminimin direkt.Gjyqi u përmbajt në zëruimin e rregullës së arsyetimit të gjithë"fuqive në treg "është e papranuar për raste të diskriminimit indirekt duke e kufizuar me marrëveshje kolektive S.A.Rivara „Diskriminacione, guistifikacione ed effektivita nella recente guisupredencia della Corte Hervey ” . Barazi gjinore në treg të njëjtë. Regullat e reja të gjyqit të Evropës për drejtësi 1995 32 CML. REV 443.461 – 469.

Shih përfudimet e seminarit të Këshillit të Evropës për pjesëmarrjen e grave në ndalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, Strazbur 20.21.9.2001 ( EG / Sem / 2001 ) 7.

Doracak për maqinerinë nacionale për promovimin e barazisë gjinore, plane dhe veprime, EG ( 2001 ) 7.

Shih shembujt në publikimin „ Arritja e barazisë gjinore ”. Botimi I Këshillit Të E. 2002, ISBN 92-871-4901-1.

Rekomandimi 1555 ( 2002 ) për imixhin e grave në medime I DOK 9394 raportuese zonja Lopez Gonzales

Ky opservatorium I cili I ka raportuar kryeministrin ishte I themeluar me Dekret më 18.10.1995.

Në fillim përbëhej nga 18 anëtarë ( meshkuj, femra ) të zgjedhur për shkak të njohurive, kryeministri ka qenë kryesues I këtj organi, I cici është përtrirë me dekret 25.11.2002 dhe ka numëruar 33 anëtarë:parlamentarë, punëtorë shoqëror, juristë historianë sociolog specialistë politikanë të cilët janë ekspertë të kësaj lëmie. Ato I ka kordinuar një raportues gjeneral. Funksionet e opservatoriumit janë rritu dhe ai tani është përgjegjës për

- Identifikim evaluim dhe analizë të pabarazisë mes meshkujve dhe femrave në fushën e politikës, ekonomisë etj.
- Prodhimi dhe diseminimi I të dhënave për pozitën e femrave në nivel nacional dhe internacional
- Propozime, rekomandime dhe mendime me qëllim që të bëhet implementim I paritetit mes grave dhe burrave.

Veb – sajd: <http://observatoire-parite.gouv.fr>

Në Francë të gjithë kandidatët në zgjedhje duhen të japin deklaratë me këto të dhëna: mbiemri, emri, gjinia, profesioni, mosha ( niveli I shkollimit në aspekt formal

s'është I nevojshëm ). Statistikat e kandidatëve të zgjedhur pastaj elaborohen në cecilin departament të zyrës zgjedhore të secilës prefekturë. Këto statistika dorëzohen në Ministrinë për punë të brendshme e cila I mbledh shënimet me qëllim të botojë statistikat nacionale.

Shih rekomandimin 1555 ( 2002 ) Kuvendi parlamentar për imixhin e grave në medime.

Më 1997/1998 është bërë një hulumtim komparativ në Norvegji, Suedi, Danimarkë, Holandë të cilët kanë punuar së bashku me „ Rrjeta për profile gjinore ” Holandë, që të hulumtohet mënyra se si burrat dhe gratë janë të profiluar në TV ( kush flet 1997/1998 ).Kriteri I cili është përdorur ka qenë kohë zgjatja e prezentimit .

Gjithsej 350 orë në TV, 10.000 persona janë analizuar. Studimi zbulon struktura jo të barabartë në kohë mesatarja e 66 % burra kundrejt 33 % gra. Dallimet mes vendeve të hulumtuara janë marginale e poashtu Gjermania dhe Belgjika tregojnë rezultate të ngjajshme.

Në Norvegji ky hulumtim është bërë 10 vite. Pas një përparimi të vogël fillestar, mesatarja është e njëjtë edhe pas 10 viteve. Tendencë të një ..... negative ka treguar edhe Holanda. Si do qoftë ka dallime të mëdha mes zhanreve programore : barazi më e madhe vërejtur në programe për fëmijë dhe të rinj dhe në programet religjioze edhe pse proporcioni 50 % femra nuk kalohet proporcionet janë shumë të pabarabarta në programet sportive në Holandë 97 % tëb njerëzve që paraqiten në programet sportive janë të gjinisë mashkullore.

Nga rezultatet e këtij hulumtimi se femrat janë shumë pak të vërejtura në TV, kjo do të thotë shumë pak mundësi për krijimin e identitetit. Në nivel simbolik mund të themi se gratë kanë më pak hapësirë dhe se llogariten si më pak të rëndësishme.Hulumtimet kualitative zbulojnë se gratë kanë status më të ulët dhe rrespekt më të vogël.

Burim: Fjalimi I z-njës Bernadet van Dijk,shefe e NOSdepartamentit për gjini në Holandë,në punëtorinë për “të mira” „të këqija” për imixhin e grave në medime (Strazbur,shtator 1998)

Përktheu nga maqedonishtja  
Lirie Shabani

Ministria e punes dhe politikës socijale, Departi per barazi ne mes grave dhe burrave dhe Lidhja e organizatave te grave te Republikës se Maqedonis, me perkrahje financiare te OSBE-se, me misioni ne Republikën e Maqedonis.

